



Republika e Kosovës

Република Косово / Republic of Kosovo

Qeveria / Влада/ Government

*Ministria për Komunitete dhe Kthim / Министарство за заједнице и повратак / Ministry
for Communities and Return*

**STRATEGJIA PËR MBROJTJEN DHE
PROMOVIMIN E
TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE DHE
PJESËTARËVE TË TYRE
2023-2027**

Dhjetor 2023

PËRMBAJTJA

<u>SHKURTESAT DHE PËRKUFIZIMET</u>	1
<u>I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE</u>	3
<u>II. HYRJE</u>	7
<u>III. METODOLOGJIA</u>	8
<u>IV. SFONDI</u>	9
<u><i>IV.1. KORNIZA KUSHTETUESE DHE LIGJORE PËR MBROJTJEN DHE PROMOVIMIN E TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE DHE PJESËTARËVE TË TYRE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS.</i></u>	9
<u><i>IV.1.1. Mekanizmat për mbrojtjen e komuniteteve jo-shumicë në Kosovë</i></u>	12
<u><i>IV.3. GJENDJA AKTUALE E KOMUNITETEVE DHE PJESËTARËVE TË TYRE NË KOSOVË.</i></u>	16
<u><i>IV.3.1. Personat e zhvendosur dhe të kthyerit</i></u>	16
<u><i>IV.3.2. Arsimi</i></u>	21
<u><i>IV.3.3. Punësimi dhe mirëqenia sociale</i></u>	27
<u><i>IV.3.4. Strehimi</i></u>	30
<u><i>IV.3.5. Çështjet pronësore</i></u>	34
<u><i>IV.3.6. Përdorimi i gjuhëve</i></u>	37
<u><i>IV.3.7. Shëndetësia</i></u>	39
<u><i>IV.3.8 Kultura</i></u>	42
<u><i>IV.3.9. Dhuna në baza gjinore, dhuna në familje dhe martesat e hershme</i></u>	42
<u>V. OBJEKTIVAT STRATEGJIKË DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË</u>	44
<u><i>VI.1. OBJEKTIVI STRATEGJIK 1</i></u>	45
<u><i>VI.2. OBJEKTIVI STRATEGJIK 2</i></u>	47
<u><i>VI.3. OBJEKTIVI STRATEGJIK 3</i></u>	52
<u>VI. ANALIZA SWOT</u>	52
<u>VII. RREGULLIMI I ZBATIMIT, MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT</u>	55
<u>VIII. NDIKIMI BUXHETOR I ZBATIMIT TË STRATEGJISË</u>	57
<u>IX. PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË PËR MBROJTJEN DHE PROMOVIMIN E TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE DHE PJESËTARËVE TË TYRE 2023-2027</u>	60

SHKURTESAT DHE PËRKUFIZIMET

AKKVP	Agjencia e Krahasimit dhe Verifikimit të Pronave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
ECMI	Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
KB	Kombet e Bashkuara
KKK	Këshilli Konsultativ për Komunitete
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MD	Ministria e Drejtësisë
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
OJQ	Organizata Jo-qeveritare
OBSSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
ILO	Organizata Botërore e Punës
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PZH	Personat e Zhvendosur
PZHBV	Personat e Zhvendosur Brenda Vendit
PZHR	Personat e Zhvendosur në Rajon
UNDP	Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara
UNHCR	Komisioni i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët
UNMIK	Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UNSCR	Rezoluta e Këshillit të Sigurisë Kombeve të Bashkuara
USAID	Agjencia për Zhvillim Ndërkombëtar i SHBA-së
ZÇK	Zyra për Çështje të Komuniteteve
ZKKK	Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZPS	Zyra për Planifikim Strategjik

Komunitetet – janë të përcaktuara si grupe nacionale, etnike, kulturore, gjuhësore ose fetare, tradicionalisht të pranishme në Kosovë, të cilat nuk janë shumicë. Këto grupe janë komunitetet serbe, turke, boshnjake, rome, ashkali, egjiptiane, goranë, malazeze, kroate dhe komunitete të tjera.¹

Shprehjet **kthimi** dhe **të kthyerit** - nënkupton zgjidhjet e qëndrueshme si kthimin në vendin e tyre të origjinës, integrimin lokal dhe vendosjen në ndonjë vend tjetër në Republikën e Kosovës;²

Personi i Zhvendosur (PZH)– nënkupton personin i cili ka qenë i detyruar të largohet ose i detyruar të lë vendin e tij/saj të banimit në veçanti, si rezultat ose në mënyrë që t'i shmanget efekteve të konfliktit të armatosur, situatës së dhunës së përgjithshme, shkeljeve të të drejtave të njeriut;³

Personi i zhvendosur brenda vendit (PZHBV) – nënkupton personin e zhvendosur brenda territorit të Republikës së Kosovës;

Personat e zhvendosur në rajon apo refugjatë (PZHR) - nënkupton personat e zhvendosur në Serbi, Mali i Zi, ose në Republikën Veriore të Maqedonisë;

Kthimi spontan – nënkupton kthimin e personave të zhvendosur pa ndonjë paralajmërim dhe pa asistencë;

Kthimi i ndihmuar – nënkupton kthimin e personave të zhvendosur të cilëve u ofrohet asistenca para, gjatë dhe pas kthimit;

Asistenca - nënkupton ofrimin e ndihmës për mbështetjen e të kthyerve vullnetarë për të arritur zgjidhje të qëndrueshme;

Zgjidhje e qëndrueshme - nënkupton arritjen e kushteve në bazë të cilave të kthyerit nuk kanë më nevojë për asistencë dhe gëzojnë të drejtat e garantuara qytetare;

Kthimi në vendin e origjinës – nënkupton kthimin e personave të zhvendosur në vendbanimin e origjinës;

Integrimi lokal – nënkupton integrimin e personave të zhvendosur në vendin e zhvendosjes;

Kthimi në vend tjetër - nënkupton vendosjen e personave të zhvendosur diku tjetër në Kosovë;
Ri-integrimi – nënkupton ri përfshirjen e të kthyerve vullnetarë në shoqërinë e Kosovës dhe respektimin e të drejtave të tyre;

¹ Ligji Nr. 04 / L-020 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Anëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2531>

² Neni 3, paragrafi 1.3 i Rregullores (QRK) - Nr. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme, e miratuar në mbledhjen e 23 - të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin e Qeverisë nr.06/23 të 4 janarit 2018.

³ Po aty, neni 3, paragrafi 1.4. Termet në vijim janë marrë nga i njëjti nen i rregullores në fjalë.

Persona të cenusëshëm – nënkupton personat e zhvendosur dhe të kthyerit që kanë nevojë për masa të veçanta si rezultat i zvogëlimit të kapacitetit të tyre funksional, për shkak të sëmundjes ose aftësisë së kufizuar ose si pasojë e situatës së tyre familjare, moshës ose gjinisë.⁴

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Strategjia për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre 2023-2027 është hartuar nën udhëheqjen e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, që paraqet një vazhdimësi të politikave të Qeverisë së Kosovës për forcimin e karakterit shumë-etnik dhe shumë-kulturor të shoqërisë kosovare. Qëllimi i strategjisë është që të forcojë mbrojtjen dhe të ofrojë zgjidhje të qëndrueshme si pjesë e reagimit kolektiv të aktorëve përkatës në mbështetje të personave të zhvendosur dhe të kthyerve vullnetarë. Kjo strategji synon gjithë përfshirjen e komuniteteve në lidhje me arsimin, punësimin dhe mirëqenien sociale, strehimin, çështjet pronësore, përdorimin e gjuhëve dhe shëndetësinë. Kjo strategji gjithashtu është paraparë edhe në Programin e Qeverisë së Kosovës 2021–2025 dhe në Planin Kombëtarë për Zhvillim (PKZH) dhe Operacional të MKK-së, si dhe është në përputhje me Planin e Veprimit të Agjendës për Reforma Evropiane, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 4 tetor 2021. Në vazhden e përpjekjeve të ekzekutivit për të përmirësuar gjendjen e komuniteteve jo-shumicë, Qeveria e Kosovës, me Vendimin nr.02/89 të datës 20 korrik 2022, ka miratuar edhe Strategjinë për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Romë dhe Ashkali në Kosovë 2022-2026 dhe Planin e Veprimit 2022-2024.

Strategjia për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre 2023-2027 mund të rishikohet pas regjistrimit të popullsisë, njëkohësisht kjo strategji duhet të sinkronizohet me Strategjinë për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Romë dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026

Gjatë hartimit të këtij dokumenti janë marrë parasysh mësimet e nxjerra nga raporti i zbatimit të Strategjisë paraprake për Komunitete dhe Kthim 2014-2018, Programi i Qeverisë së Kosovës për vitet 2021-2025, raportet, studimet dhe dokumentet vlerësuese të organizatave të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare për komunitetet, të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe UNHCR, si dhe strategjitë e tjera sektoriale. Në vijim po japim një përmbledhje të shkurtër të sfidave sipas këtyre fushave:

Arsimi: pavarësisht përpjekjeve të Qeverisë së Kosovës për ofrimin e arsimit për të gjitha komunitetet në Kosovë, përfshirë korrikulat në gjuhën e tyre në arsimin parauniversitar, vendosjen e kuotave për pranimin në universitete dhe njohjen e diplomave të arsimit të lartë, komunitetet jo-shumicë përballen me shumë sfida në integrimin e tyre më nivelet e ndryshme të arsimit në Kosovë, e kjo vlen sidomos për komunitetet romë, ashkali dhe egjiptiane si grupe më të cenushme për shkak të kushteve të tyre socio-ekonomike. Në anën tjetër, komuniteti Serb dhe një pjesë e komuniteteve të tjera, komuniteti Romë, Ashkali dhe Egjiptianë ende vazhdojnë të ndjekin arsimin në sistemin serb.

⁴ Rregullore (QRK) - Nr. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme, është miratuar në mbledhjen e 23 - të Qeverisë së Republikës së Kosovës me vendimin nr.06/23 të dt.04.01.2018.

Punësimi dhe mirëqenia sociale: Papunësia në Kosovë ka mbetur një nga sfidat kryesore përgjatë viteve jo vetëm për komunitetet jo shumicë në Kosovë por edhe për tërë qytetarët e Kosovës. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, shkalla e papunësisë në vitin 2022 ishte 12.6%. Pavarësisht, kornizës së konsoliduar ligjore dhe mekanizmave të krijuar, një nga pesë shtetas të Kosovës konsiderohet i varfër sipas statistikave zyrtare, i cili përballet me vështirësi për t'u qasur në shërbimet bazike, duke përfshirë qasjen në shërbimet shëndetësore dhe në arsim. Papunësia prekë të gjitha shtetasit e shoqërisë, por në mënyrë disproporcionale komunitetet jo-shumicë dhe përkeqëson edhe më tej situatën e tyre shpesh të vështirë të strehimit dhe sociale-ekonomike, veçanërisht atë të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptiane. Në anën tjetër, përfshirja e ulët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptiane në skemat e mirëqenies sociale dhe shfrytëzimi i pamjaftueshëm i shërbimeve sociale vështirëson zbutjen e varfërisë në mesin e këtyre komuniteteve, gjë që paraqet një sfidë shumë serioze.

Strehimi: Sipas të dhënave të UNHCR-së, rreth 15 strehimore kolektive në pjesën veriore të Kosovës strehojnë rreth 57 familje të zhvendosura me 139 individë, kryesisht të komuniteti serb, rom, ashkali, egjiptian si dhe refugjatë. Projektet të ndryshme nga donatorë ndërkombëtarë në bashkëpunim me MKK kanë financuar aktivitete për mundësi të integritit socio-ekonomik dhe përmirësimin e kushteve të banimit, sidomos në ndërtimin e shtëpive dhe rrugëve, ndërtimin e objekteve sportive dhe rregullimin e sistemeve të ujërave të zeza. Po ashtu, MKK-ja ka financuar projekte në fushën e arsimit, kulturës, sportit, ngjarjeve fetare dhe shumë fusha të tjera të rëndësishme për cilësinë e jetës së qytetarëve.

Çështjet pronësore: Megjithëse është vërejtur përparim në adresimin e të drejtave pronësore të komuniteteve jo-shumicë dhe personave të zhvendosur, sidomos në kompletimin e kornizës ligjore në këtë drejtim, këto kategori ende përballen me probleme pronësore. Kjo vjen kryesisht për shkak të uzurpimit dhe ri uzurpimit të pronave të tyre dhe numrit të ulët të dëbimeve të këtyre uzurpatorëve të paligjshëm nga ana e institucioneve kompetente si dhe numrit të ulët të rrënimave të strukturave të paligjshme⁵ të ndërtuara në këto prona. Kthimi i pronave nga uzurpimi i paligjshëm do të ndikojë në rritjen e sigurisë juridike të personave të zhvendosur dhe rrjedhimisht në kthimin e tyre. Në këtë drejtim, duhet të hartohet një plan veprimi konkret që do të përmbajë të gjitha masat për dëbimin e uzurpatorëve nga prona e uzurpuara dhe rrënimin e strukturave të paligjshme të ndërtuara ndër vite në këto prona në mënyrë që të mundësohet kthimi i personave të zhvendosur në prona të tyre.

Përdorimi i gjuhëve: Mundësia e përdorimit të barabartë të gjuhëve zyrtare përbën të drejtë themelore, të garantuar edhe me Kushtetutën e Kosovës. Ngecjet kryesore në fushën e përdorimit të gjuhëve konsistojnë në gabimet e dukshme në përkthimet e legjislacionit të Kosovës në gjuhët zyrtare, respektivisht, në gjuhën serbe, pastaj edhe sfidat me përdorimin e përkthyesve në sistemin e drejtësisë së Kosovës, si dhe në qasjen në korrikulat në gjuhët e komuniteteve në arsimin parauniversitar dhe arsimin e lartë të Kosovës. Andaj, zbatimi i plotë i legjislacionit për përdorimin e gjuhëve duhet të jetë prioritet për MKK dhe Qeverinë në përgjithësi.

⁵ **Strukturë e paligjshme** - nënkupton çfarëdo lloj ndërtimi të paligjshëm në pronën e paluajtshme private, që është ndërtuar pa pëlqim të pronarit. Shih nenin 3, paragrafi 1.5 të Udhëzimit Administrativ (QRK) - Nr.01/2020 për përcaktimin e procedurave për shkatërrimin e strukturave të paligjshme.

Shëndetësia: Jo të gjitha komunitetet jo shumicë përdorin shërbimet shëndetësore të ofruara nga Republika e Kosovës. Familjet e kthyer të romëve, egjiptianëve, ashkalive dhe shqiptarëve kryesisht përdorin shërbimet shëndetësore të Kosovës, ndërsa komuniteti serb përdori shërbime shëndetësore që janë nën administrimin e Serbisë, për shkak të sigurimit shëndetësor dhe ilaçeve falas. Kushtet e jetesës në disa vendbanime të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptiane janë shqetësuese, si dhe niveli i vaksinimit, sidomos i fëmijëve të tyre, mbetet shqetësues. Kjo reflektohet edhe sidomos pas shfaqjes së pandemisë Covid-19. Ministria e Shëndetësisë ende nuk ka të dhëna zyrtare të nivelit të vaksinimit kundër Covid-19 sipas etnisë. Duhet të ndërmerren politika të mirëfillta shëndetësore që mundësojnë qasje të barabartë dhe efektive për të gjitha komunitetet, përfshirë, një sistem të sigurimeve shëndetësore sepse kjo ndër të tjera do të nxisë edhe kthimin e personave të zhvendosur dhe përdorimin e shërbimeve shëndetësore të Kosovës të komuniteteve jo shumicë që po përdorin sistemin shëndetësor të ofruar nga Serbia.

Kultura: Jeta kulturore dhe publike, organizimi i manifestimeve kulturore dhe të tjera, përfaqësimi multi-etnik nëpër festivale si dhe ngritja e vetëdijes për respektimin e trashëgimisë kulturore dhe historike është thelbësore për komunitetet jo-shumicë. Andaj, Qeveria e Kosovës duhet të shtojë organizimet kulturore të këtyre komuniteteve në mënyrë që të ngritet integrimi kulturor i tyre në shoqërinë kosovare.

Dhuna në baza gjinore dhe martesat e hershme: Dhuna ndaj grave, dhuna në familje dhe martesat e hershme janë të pranishme dhe përbëjnë një shqetësim pansocial në Kosovë, sidomos në mesin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptiane. Qeveria e Kosovës duhet të angazhohet në organizimin e fushatave vetëdijësuese në parandalimin e dhunës në baza gjinore, dhunës në familje dhe martesave të hershme të komuniteteve jo-shumicë, me përqendrim te këto komunitete, si dhe në integrimin në shoqëri të viktimave nga këto dukuri.

Që të arrihen synimet e Strategjisë, në adresimin e problemeve të lartcekura, janë caktuar objektivat strategjike. Objektivat strategjike ndërlihen me problemet kryesore, të identifikuara në këtë strategji. Të njëjtat synojnë integrimin dhe zgjidhjen e qëndrueshme për personat e zhvendosur dhe të kthyerit, stabilizimin e komuniteteve dhe përmirësimin e mirëqenies së tyre, duke ofruar mbrojtje sociale, mundësi të barabarta të punësimit dhe arsimit, forcimin e kohezionit social në nivelin e komuniteteve, promovimin e diversitetit dhe të trashëgimisë kulturore si dhe zhvillimin e mekanizmave dhe shërbimeve për përdorimin e gjuhëve. Objektivat strategjike janë përcaktuar si në vijim:

Objektivi strategjik 1: Kthimi, ri integrimi, integrimi dhe ofrimi i mundësive të zgjidhjes së qëndrueshme për personat e zhvendosur dhe të kthyerit vullnetarë jo-shumicë, me objektivat specifike si në vijim:

Objektivi specifik 1.1. Angazhim i intensifikuar i institucioneve relevante në lidhje me ofrimin e shërbimeve për kthimin dhe ri integrimin e personave të zhvendosur;

Objektivi specifik 1.2. Avancimi i kornizës ligjore në fushën e integritit të të kthyerve dhe komuniteteve në Kosovë;

Objektivi specifik 1.3. Forcimi i koordinimit në mes të qeverisjes lokale dhe qendrore sa i përket zgjidhjes së qëndrueshme;

Objektivi specifik 1.4. Mbyllja e qendrave kolektive;

Objektivi specifik 1.5. Kthimi vullnetarë dhe urban.

Objektivi strategjik 2: Stabilizimi i komuniteteve dhe përmirësimi i mirëqenies së tyre duke ofruar mundësi të barabarta të punësimit, shërbimeve sociale dhe të mbrojtjes, si dhe arsimit, me objektivat specifikë si në vijim:

Objektivi specifik 2.1. Rritja e mundësive për punësim të komuniteteve jo-shumicë me fokus të veçantë në grupet e cënueshme siç janë të kthyerit, gratë, të rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuara;

Objektivi specifik 2.2. Rritja e mundësive për arsim të përgjithshëm, arsim dhe aftësim profesional të komuniteteve jo-shumicë me fokus të veçantë në grupet e cënueshme siç janë gratë, të rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuara;

Objektivi specifik 2.3: Përkrahja e zhvillimit, kultivimit dhe ruajtjes së diversitetit kulturor, identitetit kulturor e atë kombëtar të komuniteteve jo-shumicë dhe dialogu ndërkulturor.

Objektivi strategjik 3: Përfaqësimi proporcional i komuniteteve pakicë në administratën publike, me objektivat specifikë si në vijim:

Objektivi specifik 3.1: Formimi i një organi qeveritar për zhvillimin e kornizës juridiko-institucionale për integrimin e komuniteteve jo shumicë në administratën publike të Kosovës;

Objektivi specifik 3.2: Sigurimi i mbështetjes ligjore dhe teknike për monitorimin e zbatimit të programit.

Objektivi strategjik 4: Zhvillimi i mekanizmave dhe shërbimeve për përdorimin e gjuhëve, me objektivat specifikë si në vijim:

Objektivi specifik 4.1. Përmirësimi i harmonizimit dygjuhësor gjatë hartimit të legjislacionit në Kosovë.

II. HYRJE

Kosova ka mbështetur në mënyrë të konsiderueshme nismat ndërkombëtare dhe vendore drejt mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të komuniteteve në Kosovë. Që nga shpallja e pavarësisë në shkurt 2008, institucionet e Kosovës kanë hartuar një strategji për komunitete dhe kthim për periudhën 2014-2018. Ndërsa, sa i përket kornizës kushtetuese dhe ligjore, Kosova konsiderohet të jetë lider në krahasim me shtetet e rajonit sa i përket të drejtave të garantuara për komunitetet jo-shumicë në Kosovë, duke i kushtuar një kapitull të veçantë kësaj kategorie, përveç kapitullit të të drejtave themelore, si dhe ka miratuar një ligj të veçantë dhe legjislacion shtesë që të sigurojnë të drejtat e tyre.

MKK ka hartuar strategjinë e parë për komunitet në vitin 2013, respektivisht, “Strategjinë për Kthim dhe Komunitete 2014-2018”, gjë që paraqet një vazhdimësi të politikave të Qeverisë së Kosovës për forcimin e karakterit shumë-etnik dhe shumë-kulturor të shoqërisë kosovare. Gjithashtu, në kuadër të Programit të Qeverisë së Kosovës për vitet 2021-2025, prioritet i Qeverisë është edhe përmirësimi i politikave për komunitetet përmes hartimit të koncept dokumentit dhe ligjit për personat e zhvendosur në mënyrë që të mundësohet kthimi i sigurve dhe dinjitetshëm i tyre. Në planin strategjik dhe operacional të MKK-së për vitet 2021-2025, miratimi i Strategjisë për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre është paraparë në kuadër të qëllimit strategjik “Përmirësimi i politikave për komunitetet, kthimi dhe integrimi” dhe objektivit operacional “Zhvillimi dhe ndryshimi i ligjeve dhe akteve nënligjore për komunitetet”. Si dhe në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2030, për fëmijët nga komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane, është thelbësore të përmirësohet qasja në të gjitha nivelet e arsimit dhe të promovohet arsimi i strukturuar, investimet në kujdesin shëndetësor duhet të reflektojnë një rritje të jetëgjatësisë së përgjithshme, por duhet të adresojnë veçanërisht shëndetin e fëmijëve, duke reduktuar shkallën e vdekshmërisë së fëmijëve, veçanërisht ato të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane. Po ashtu, më 3 dhjetor 2020, Kryeministri i Kosovës ka miratuar prioritetet e Kornizës së OKB-së për Zhvillim të Qëndrueshëm (UNSDCF) 2021 – 2025.⁶ Kjo kornizë bazohet në sukseset dhe mësimet e nxjerra nga bashkëpunimi i kaluar dhe përfaqëson një angazhim të përbashkët të sistemit të zhvillimit të Kombeve të Bashkuara për të punuar në partneritet te ngushtë me autoritetet e Kosovës për arritjen e prioritetëve të saj të përcaktuara nga Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs), objektivat e integritit rajonal, zotimet dhe parimet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Zhvillimet dhe rezultatet e “Procesit të Shkupit” si platformë ndërinstitucionale rajonale e zgjidhjeve të qëndrueshme, janë të rëndësishme në hartimin e politikave në këtë fushë. Kjo platformë rajonale është iniciuar në vitin 2014.

Përkundër arritjeve të deritanishme, komunitetet jo-shumicë vazhdojnë të jenë në pozitë të pavolitshme në pothuajse të gjitha sferat e jetës në Kosovë. Përmirësimi i përgjithshëm i standardit të jetesës dhe kushteve socio-ekonomike për këto komunitete ballafaqohet me barriera të ndryshme, ndër të tjera, problemet me uzurpimet e pronave kanë paraqitur pengesa lidhur me kthimin e personave të zhvendosur, shëndetësisë, dhe sfidat në zbatimin e legjislacionit për përdorimin e gjuhëve kanë pamundësuar integrimin e plotë të komuniteteve jo-shumicë në Kosovë. Po ashtu, fenomeni i vazhdueshëm i përjashtimit social për një pjesë të komuniteteve jo-shumicë,

⁶ Korniza e OKB-së për Zhvillim të Qëndrueshëm (UNSDCF) 2021 – 2025, e qasshme në:

https://kosovoteam.un.org/sites/default/files/2021-01/Final%20Kosovo%20UNSDCF%202021-2025_signed.pdf

siç janë komuniteti rom dhe ashkali, vazhdon të jetë hendek i madh në përpjekjet për të përmirësuar shanset e jetës. Shumë prej tyre vazhdojnë të përballen me diskriminim, ngacmim dhe pre e përjashtimit shoqëror për shkak të përkatësisë së tyre etnike. Te gjitha këto probleme kanë ndikuar që Qeveria, respektivisht, MKK të iniciojë hartimin dhe miratimin e një strategjie të re për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.

Komunitetet jo shumice në Kosovë janë serb, turk, boshnjak, rom, ashkali, egjiptian, goran, malazez, kroat dhe komunitete të tjera.⁷

III. METODOLOGJIA

Metodologjia e përdorur për hartimin e Strategjisë është një kombinim i punëtorive dhe takimeve individuale me aktorët kyç vendor dhe ndërkombëtarë, konsultimeve me përfaqësuesit e komuniteteve jo-shumicë në nivel vendi. Pas analizës së shkurtër të gjendjes aktuale, janë përcaktuar objektivat strategjike, objektivat specifike, aktivitetet dhe veprimet konkrete, të cilat janë buxhetuar. Plani i Veprimit në aspektin strukturor është hartuar në përputhje me Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 07/2018 për planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit dhe udhëzimet e vazhdueshme të Zyrës për Planifikim Strategjik (ZPS), përmes përfaqësuesit të kësaj zyre në grupin punues.

Grupi Punues për hartimin e kësaj strategjie është themeluar nga Ministri i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim dhe u drejtua nga Drejtori i Departamentit Ligjor të kësaj ministrie, dhe përbëhet nga 20 anëtarë e përfaqësues të institucioneve përgjegjëse, si më poshtë:

1. Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK);
2. Zyra e Kryeministrit për Çështje të Komuniteteve (ZÇK);
3. Zyra e Kryeministrit për Komisionerin e Gjuhëve (ZKKGJ);
4. Zyra e Kryeministrit për Qeverisje të Mirë (ZKQM);
5. Zyrat komunale për komunitete dhe kthim në komunat e synuara (ZKKK);
6. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT);
7. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS);
8. Departamenti i Punës dhe Mirëqenies Sociale (DPMS);
9. Zyra e Presidentit të Kosovës - Këshilli Konsultativ për Komunitete (ZPKKKK);
10. Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK);
11. Ministria e Pushtetit dhe Administratës Lokale (MAPL);
12. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI);
13. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH);
14. Agjencia Kosovare për Krahasimin dhe Verifikimin e Pronës (AKKVP);
15. Zyra e Kryeministrit për Planifikim Strategjik (ZKPS);
16. Qendrat Rajonale dhe Lokale të punësimin;
17. Organizatat e shoqërisë civile dhe akterët e tjerë relevantë aktivë në fushën e kthimit dhe ri integritit të komuniteteve pakicë;

⁷ Ligj për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/1-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2531>

18. Organizatat tjera ndërkombëtare në Kosovë, agjencitë e OKB-së, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe Këshilli Danez për Refugjatët (DRC).

Puna e Grupit Punues në hartim të strategjisë është mbështetur edhe nga zyra e IOM-it në Kosovë, përmes ekspertit të tyre të angazhuar.

Procesi i hartimit të strategjisë ishte i ndarë në tri fazë: 1) faza e parë është karakterizuar me analizimin e situatës së përgjithshme, si dhe realizimin e një seri të takimeve konsultative, në të cilat kanë qenë të përfshirë institucionet përgjegjëse dhe aktorët relevant që punojnë në nivel lokal; 2) përgjatë fazës së dytë, ekipi përgjegjës për hartimin e strategjisë ka analizuar dokumentet strategjike në fuqi, raportet, studimet dhe dokumentet vlerësuese të ndryshme vendore e ndërkombëtare dedikuar komuniteteve, veçanërisht rezultatet e zbatimit të Strategjisë paraprake për Komunitete dhe Kthim 2014-2018, Programin e Qeverisë së Kosovës 2021–2025, të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, si dhe strategjitë e tjera sektoriale; ndërsa 3) në fazën e tretë dokumenti i është nënshtruar procesit të konsultimeve me të gjitha palët e interesit, duke synuar identifikimin dhe adresimin e të gjitha çështjeve që lidhen me palët specifike. Këto takime janë zhvilluar përgjatë tërë fazës së konsultimeve paraprake dhe publike. Grupi Punues ndërinstitucional ka shqyrtuar dhe inkorporuar inputet e pranuar nga këto konsultime dhe sipas kriterëve të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2012 është proceduar për aprovim.

Përveç kësaj, janë mbajtur takime individuale dhe grupe me përfaqësues të ministrive me qëllim të analizimit të gjendjes aktuale të zbatimit, monitorimit dhe mekanizmave raportues qendror.

Versioni përfundimtar i Strategjisë për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre 2023 – 2027 dhe Plani i saj i Veprimit, u dërgua për miratim në Qeverinë e Kosovës, më 10.08.2023.

IV. SFONDI

IV.1. KORNIZA KUSHTETUESE DHE LIGJORE PËR MBROJTJEN DHE PROMOVIMIN E TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE DHE PJESËTARËVE TË TYRE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë janë të garantuara me Kushtetutën e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta),⁸ Ligjin nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-020, si dhe Ligjin nr. 04/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me Përfundimin e Mbikëqyrjes Ndërkombëtare të Pavarësisë së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për të Drejtat e Komuniteteve),⁹ si dhe me anë të instrumenteve juridike ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të zbatueshme drejtpërdrejtë përmes nenit 22 të Kushtetutës.

⁸ Shih Kapitullin II, III, dhe nenet 64, 67, 78, 81, 96, 103, 108, 110, 114, 123, 126, 133, 139, 144 dhe 156 (të amendamentuar) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e qashme në Gazetën Zyrtare, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

⁹ Shih Ligjin nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-020, i qasshëm në Gazetën Zyrtare, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2531>

Neni 156 i Kushtetutës garanton Kosova promovon dhe lehtëson kthimin e sigurt dhe me dinjitet të refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit, dhe u ndihmon atyre për kthimin e pronave dhe posedimeve të tyre. Me qëllim të respektimit të identitetit gjuhësor të të gjithë personave dhe me qëllim të krijimit të një mjedisi për të gjitha komunitetet që të shprehin dhe të ruajnë identitetin e tyre gjuhësor, dhe me qëllim që të rregullojë përdorimin e gjuhëve, Kuvendi ka miratuar edhe Ligjin Nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve,¹⁰ ndërsa në aspektin e ruajtjes së identitetit të tyre kulturor dhe arsimor, Kuvendi ka miratuar Ligjin Nr.02/L-88 për Trashëgiminë Kulturorë,¹¹ Ligjin Nr.03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura,¹² dhe Ligjin Nr. 03/L-068 mbi Arsimin në Komunitat e Kosovës.¹³

Ligji për Mbrojtjen e Komuniteteve përcakton se Kosova garanton barazi të plotë dhe efektive për të gjithë popullin e Kosovës. Kosova e konsideron shumëllojshmërinë e saj kombëtare, etnike, gjuhësore dhe fetare si një burim force dhe pasurie për zhvillimin e mëtejshëm të një shoqërie demokratike që bazohet në sundimin e ligjit. Në zhvillimin e Kosovës, inkurajohet dhe çmohet kontributi aktiv i të gjithë personave që iu përkasin komuniteteve.¹⁴ Po ashtu, përmes këtij ligji është krijuar baza ligjore për ndërmarrjen e masave të veçanta për të siguruar barazi të plotë dhe efektive për komunitetet dhe pjesëtarët e tyre, duke marrë në konsideratë nevojat e tyre të veçanta, të cilat masa nuk konsiderohen si akte diskriminimi.¹⁵

Kapitulli III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] i Kushtetutës në mënyrë të veçantë i trajton të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, duke rregulluar të drejtat e tyre si individë dhe komunitete, parimet e përgjithshme, përgjegjësitë e shtetit, Këshillin Konsultativ për Komunitete, përfaqësimin në punësim në institucionet publike dhe përfaqësimin në organet e pushtetit lokal. Neni 62 [Përfaqësimi në organet e pushtetit lokal] të Kushtetutës i Kushtetutës përcakton që në komunat në të cilat së paku dhjetë për qind (10%) të banorëve u përkasin komuniteteve, të cilat në ato komuna nuk janë shumicë, posti i zëvendëskryetarit për komunitete të kuvendit të komunës do të rezervohet për një përfaqësues nga radhët e këtyre komuniteteve.

Me qëllim të respektimit të identitetit gjuhësor të të gjithë personave dhe me qëllim të krijimit të një mjedisi për të gjitha komunitetet që të shprehin dhe të ruajnë identitetin e tyre gjuhësor, dhe me qëllim që të rregullojë përdorimin e gjuhëve, Kuvendi ka miratuar edhe Ligjin Nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve,¹⁶ ndërsa në aspektin e ruajtjes së identitetit të tyre kulturor dhe arsimor,

¹⁰ Shih Ligjin Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, në Gazetën Zyrtare, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2440>

¹¹ Shih Ligjin Nr.02/L-88 për Trashëgiminë Kulturorë, në Gazetën Zyrtare, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2533>

¹² Shih Ligjin Nr.03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, në Gazetën Zyrtare, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2529>

¹³ Shih Ligjin Nr. 03/L-068 mbi Arsimin në Komunitat e Republikës së Kosovës, në Gazetën Zyrtare, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2543>

¹⁴ Shih nenin 1 të Ligjit për Mbrojtjen e Komuniteteve.

¹⁵ Po aty.

¹⁶ Shih Ligjin Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, në Gazetën Zyrtare, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2440>

Kuvendi ka miratuar Ligjin Nr.02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore,¹⁷ Ligjin Nr.03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura,¹⁸ dhe Ligjin Nr. 03/L-068 mbi Arsimin në Komunat e Kosovës.¹⁹, Ligji Nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare Në Kosovë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04&L/115,²⁰ Ligjin Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës,²¹ Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës,²² dhe Ligji Nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit.²³

Përveç ligjeve të cekura më lartë, mbrojtja e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë promovohet edhe duke i'u referuar instrumenteve juridike ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të zbatueshme drejtpërdrejtë në Kosovë, si:

- (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;
- (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;
- (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;
- (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
- (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;
- (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
- (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese;
- (9) Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje.

Ndonëse ende jo anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, për shkak të rëndësisë në mbrojtjen e të drejtave të të zhvendosurve dhe rivendosjen e të drejtave pronësore pas kthimit, në Kosovë gjatë zbatimit të politikave lidhur me komunitetet dhe të kthyerit merr parasysh edhe Parimet Udhëzuese të Kombeve të Bashkuara për Zhvendosjen e Brendshme (të miratuara në shtator 2004), si dhe Parimet mbi kthimin e shtëpive dhe pronës për refugjatët dhe personat e zhvendosur (Parimet Pinheiro) nga Nën-Komisioni i OKB-së për Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (të miratuara në qershor 2005).

¹⁷ Shih Ligjin Nr.02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore, në Gazetën Zyrtare, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2533>

¹⁸ Shih Ligjin Nr.03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, në Gazetën Zyrtare, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2529>

¹⁹ Shih Ligjin Nr. 03/L-068 mbi Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, , i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2543>

²⁰ Shih Ligji Nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04&L/115, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2442>

²¹ Shih Ligjin Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13023>

²² Shih Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18917>

²³ Shih Ligjin Nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2670>

MKK, sipas legjislacionit në fuqi, vepron për të zbatuar procedurat për një jetë më të mirë dhe të mbështesë interesat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës. Në përputhje me shtojcën 1.14 të Rregullores (QRK) – Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative së Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, të ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, MKK-ja përgatit politikat publike, harton aktet ligjore, miraton aktet nënligjore, përcakton standardet e detyrueshme dhe zbaton legjislacionin në fushën e promovimit dhe mbrojtjes të të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre, duke përfshirë të drejtën për t'u kthyer, në përputhje me Kushtetutën e Kosovës.

Si rezultat i nxjerrjes së Ligjit për të Drejtat e Komuniteteve, më 4 janar 2018, Qeveria miratoi Rregulloren (QRK) - nr. 01/2018 për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme, si dhe udhëzuesin për zbatimin e kësaj rregulloreje. Qëllimi i kësaj rregulloreje është krijimi i kushteve të nevojshme për arritjen e zgjidhjeve të qëndrueshme për personat e zhvendosur brenda Kosovës dhe në rajon, dhe përcaktimi i përgjegjësisë të organeve kompetente, vendimmarrëse dhe zbatuese, të procedurave dhe kritereve për asistencë.²⁴

Në kuadër të Programit të Qeverisë së Kosovës për vitet 2021-2025, prioriteti i Qeverisë është edhe përmirësimi i politikave për komunitetet përmes hartimit të koncept dokumentit dhe ligjit për personat e zhvendosur në mënyrë që të mundësohet kthimi i sigurtë dhe dinjitetshëm i tyre.²⁵ Çështja e kthimit të personave të zhvendosur është e nevojshme të adresohet përmes miratimit të një ligji të veçantë, apo ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit Nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë, ku përveç pjesës së komuniteteve do të ndryshohet dhe plotësohet neni 3.A, i cili ka të bëjë me të drejtat e refugjatëve dhe personave të zhvendosur. Nxjerrja e kornizës ligjore adekuate do të ndikojë në sigurinë juridike të kategorisë në fjalë.

IV.1.1. Mekanizmat për mbrojtjen e komuniteteve jo-shumicë në Kosovë

Përmes mekanizmave të ndryshëm në nivelin qendror, ashtu edhe në atë lokal, Kosova mundëson përkrahjen për të drejtat e komuniteteve jo shumicë. Përderisa, disa nga këto mekanizma kanë të bëjnë me mbrojtjen e tyre nga diskriminimi, të tjerat merren edhe me çështje që lidhen me pjesëmarrjen në vendimmarrje.

Këshilli Konsultativ për Komunitete, vepron nën autoritetin e Presidentes së Republikës së Kosovës, në të cilën përfaqësohen të gjitha komunitetet.

Mandati i Këshillit Konsultativ për Komunitete përfshin:

- 1) Ofrimin e një mekanizmi për shkëmbim të rregullt ndërmjet komuniteteve dhe Qeverisë së Kosovës;
- 2) Mundësin e komuniteteve për të komentuar në një fazë të hershme nismat legislative dhe politike, të cilat mund të përgatiten nga Qeveria, për të zgjeruar nisma të tilla dhe për të kërkuar që pikëpamjet e tyre të përfshihen në projektet dhe programet përkatëse;

²⁴ Shih nenin 1 të Rregullores (QRK) - nr. 01/2018 për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme, e qasshme në Gazetën Zyrtare, vegëza: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15942>

²⁵ Shih Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitet 2021-2025, të miratuar me Vendimin e Qeverisë, nr. 01/11, të dates 07.05.2021, f. 25.

- 3) T'u japë rekomandime gjatë vendimmarrjes në lidhje me ndarjen e fondeve ndërkombëtare apo ndarjen e fondeve nga buxheti i Republikës e Kosovës për projekte të dedikuara për komunitete.

Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.²⁶ Kjo nënkupton se mbron të drejtat dhe liritë e komuniteteve jo shumicë në Kosovë.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim është komision i përhershëm i Kuvendit të Kosovës, me përfaqësim të garantuar të komuniteteve jo-shumicë. Përveç rolit të tij të përgjithshëm në Kuvendin e Kosovës, ky komision është i ngarkuar me detyrën e vlerësimit të pajtueshmërisë së legjislacionit të propozuar me të drejtat e komuniteteve, dhe për të siguruar që këto të drejta të adresohen në mënyrë adekuate.

Zyra për Çështje të Komuniteteve është njësi organizative në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, e cila ka për mision të ndihmojë Zyrën e Kryeministrit dhe Qeverinë në përcaktimin dhe zbatimin e politikave në mënyrë të unifikuar dhe koherente, duke analizuar, këshilluar dhe mbështetur hartimin e politikave për çështje të komuniteteve dhe monitorimin e zbatimit të tyre.

Zyra për Qeverisje të Mirë është njësi organizative në kuadër të Zyrës së Kryeministrit që nga viti 2002, e cila ka për mision të ofrojë mbështetje profesionale në punën e Zyrës së Kryeministrit dhe Qeverisë, në fushën e qeverisjes së mirë, të drejtave të njeriut, mbrojtjes nga diskriminimi, të drejtave të fëmijëve, të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe mundësive të barabarta. Promovimin e të drejtave të komuniteteve jo shumicë e bën nga këndvështrimi i mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Zyra e Komisionerit për Gjuhët vepron në kuadër të Zyrës së Kryeministrit nën udhëheqjen e Komisionerit për Gjuhët, i cili është përgjegjës për menaxhimin e Zyrës dhe ushtrimin e kompetencave të saj në pajtim me Rregulloren përkatëse për Zyrën e Komisionerit për Gjuhët. Komisioneri për Gjuhët Zyra mbikëqyrë zbatimin e Ligjit, me qëllim të ruajtjes, promovimit dhe mbrojtjes së: përdorimit të gjuhëve zyrtare në Kosovë, gjuhëve zyrtare të komunave, gjuhëve në përdorim zyrtarë në komuna, si dhe gjuhëve të komuniteteve gjuha amtare e të cilave nuk është njëra prej gjuhëve zyrtare.

Ministria për Komunitete dhe Kthim është themeluar në vitin 2005, dhe është ministria kyçe e ngarkuar me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre. Kjo ministri harton dhe zbaton legjislacionin dhe politikat e tjera publike në këtë fushë, duke përfshirë të drejtën për t'u kthyer në Kosovë.

Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim veprojnë në pajtim me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi dhe me politikat në fushën e promovimit të të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, siguron qasje të barabartë në shërbimet publike, krijim të kushteve për kthim dhe re integrim të qëndrueshëm, përfshirë dokumentet strategjike të Kosovës që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe

²⁶ Shih nenin 132 të Kushtetutës.

promovimin e të drejtave të komuniteteve, kthimin dhe ri integrimin e tyre. Zyrat identifikojnë, promovojnë, përkrahin, zbatojnë dhe mbikëqyrin politikat, aktivitetet dhe programet përkatëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve; qasjen e barabartë të komuniteteve në shërbime publike; krijimin e kushteve për kthimin e qëndrueshëm të refugjatëve, të të kthyerve, personave të zhvendosur dhe atyre të riatdhesuar.²⁷

Zëvendës kryesuesi për Komunitete është post i rezervuar në Kuvendin Komunal nga komuniteti jo-shumicë i caktuar, në komunat ku të paktën 10% e popullatës së komunës i përket komunitetit jo-shumicë. Ky post parashihet në dispozitat kushtetuese, përkatësisht nenin 62 të Kushtetutës. Përkundër përkufizimit të tij kushtetues, ky mekanizëm ka përkufizim shumë të ngushtë në legjislacionin ekzistues dhe nuk ka asnjë udhëzim të veçantë administrativ për të dhënë ndonjë hollësi përkitazi me detyrat e tij, përfshirë edhe kohën se sa kjo pozitë mund të jetë vakante. Në vitin 2019, pozitat e zbrazëta veç i kishin prekur komunitetet në një komunë, duke dobësuar përfaqësimin politik dhe mbrojtjen e tyre.²⁸ **Zëvendëskryetari i Komunës për Komunitete** parashihet në Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale, i cili post rezervohet për ato komuna ku të paktën 10% e qytetarëve të asaj komune i përkasin komuniteteve jo-shumicë. Kjo pozitë nuk është e detyrueshme. Që nga viti 2014, Udhëzimi administrativ nr. 01/2014 për procedurën e emërimit të nënkryetarëve në komuna, i cili parashihte detyra të rëndësishme, megjithëse të kufizuara, por edhe përbërje dhe kriteret të rëndësishme të përzgjedhjes së kësaj pozite, rregullonte këtë pozitë deri në vitin 2020, kur edhe është nxjerrë udhëzimi i ri administrativ. Kjo pozitë është integruar në masë të madhe në infrastrukturën vendimmarrëse të komunës, me më shumë takime me kryetarin e komunës se sa që parashihet në kornizën e politikave, dhe faktin se të njëjtit kanë në përgjithësi bashkëpunim të fuqishëm dhe ndërveprime me strukturat ekzekutive komunale.²⁹

Komitetet për komunitete - komiteti përfshin në radhët e veta shumicën e thjeshtë nga anëtarët e kuvendit të komunës, anëtarët e tjerë janë përfaqësuesit e komuniteteve. Çdo komunitet që jeton në komunë përfaqësohet nga, së paku një përfaqësues në komitetin për komunitete. Përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë në komunë e përbëjnë shumicën e anëtarëve të komitetit të komuniteteve. Komiteti i komuniteteve është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Komiteti gjithashtu i rekomandon kuvendit të komunës masat që duhet të ndermirren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.³⁰


²⁷ Shih nenin 2 të Rregullores Nr. 02/2010 për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim, e qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10522>

²⁸ Raport i OSBE-së, *Vlerësim i themelimit, funksionalizimit dhe performancës së mekanizmave komunalë të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të komuniteteve*, tetor 2021, f. 43, i qasshëm në: <https://www.osce.org/files/f/documents/b/3/499822.pdf>

²⁹ Po aty, f. 36-37.

³⁰ Shih nenin 53 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>.

Figura 1. Mekanizmat për mbrojtjen e komuniteteve jo shumicë në Kosovë



IV.3. GJENDJA AKTUALE E KOMUNITETEVE DHE Pjesëtarëve të tyre në Kosovë

Pavarësisht garancive kushtetuese dhe ligjore që i ofrohen komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë, është e nevojshme që zbatimi i tyre të monitorohet dhe përmirësohet nëse është e nevojshme përmes identifikimit të ngecjeve në zbatim dhe analizës së gjendjes aktuale të tyre. Në nënkapitujt në vijim, do të analizohet gjendja aktuale e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre sipas tematikave specifike, konkretisht, në fushën e personave të zhvendosur dhe të kthyer, arsimit, punësimit dhe mirëqenies sociale, çështjeve pronësore, përdorimit të gjuhëve dhe shëndetësisë.

IV.3.1. Personat e zhvendosur dhe të kthyerit

MKK nuk ka mbajtur statistika për personat e zhvendosur dhe të kthyer në Kosovë. Andaj, në mungesë të bazës së të dhënave zyrtare në Kosovë, UNHCR ka regjistruar dhe mirëmbajtur bazën e të dhënave për të kthyerit deri më sot. Tashmë, MKK me ndihmën e IOM-it ka krijuar këtë bazë të të dhënave dhe që nga 1 marsi 2023 është funksionalizuar. .

Tabela 5. PZhBV* sipas rajonit dhe etnisë (raporti i UNHCR-së, shkurt 2023)

C.1.	K/PZhBV* për rajon dhe entitetet							
	Rajoni i zhvendosjes	Shqiptar	Ashkali	Egjiptian	Goran	Romë	Serb	Të tjerë
Gjilan/Gnjilane	0	80	0	0	30	561	0	671
Mitrovicë/Mitrovica	6900	0	2	15	27	6854	7	13805
Pejë/Peć	0	0	0	0	0	19	0	19
Prishtinë/Priština	0	28	0	0	92	928	0	1048
Prizren	0	45	0	0	3	55	0	103
Total	6900	153	2	15	152	8417	7	15646

* Shifrat janë vlerësime, bazuar në një anketë sistematike të kryer nga UNHCR. Zvogëlimi i numrit reflekton të kthyerit e regjistruar nga brendësia e Kosovës.

Sipas pasqyrës statistikore të nxjerrë nga UNHCR në shkurt të vitit 2023, vlerësohet se rreth 15,646 persona janë zhvendosur brenda vendit në Kosovë. Kur analizohen këto të dhëna në baza etnike dhe rajonale, vërehet se pjesa më e madhe e personave të zhvendosur brenda vendit i takon komunitetit serb (8,417), pastaj komunitetit shqiptar (6,900), komunitetit rom (152), komunitetit ashkali (153), komunitetit goran (15) dhe atij egjiptian (2). Kryesisht, rajonet nga të cilat janë zhvendosur këto komunitete janë rajoni i Mitrovicës me më së shumti PZHBV të komunitetit serb dhe shqiptar, pastaj nga rajoni i Prishtinës ku prin komuniteti serb, rom dhe ashkali, më pas nga

rajoni i Gjilanit ku prin komuniteti serb, ashkali dhe rom e në fund rajonet e Prizrenit dhe Pejë nga të njëjtat komunitete (shih tabelën 5).

Gjatë vitit 2016, profilizimi i PZHBV-ve³¹ është bërë në bazë të një mostre të mbështetur nga JIPS (Joint IDP Profiling Service). Profilizimi u bë në bazë të mostrës nën menaxhimin e një organi administrativ që përbëhej nga Ministria për Komunitete dhe Kthim, Komisioneri për Refugjatët dhe Migracioni i Republikës së Serbisë, UNHCR dhe Këshilli Danez i Refugjatëve (Grupi i Menaxhimit të Profilizimit). Mbështetje e mëtejshme është ofruar nga JIPS, si dhe një numër i punonjësve aktivë në Kosovë të cilët kanë kontribuar në Grupin e Menaxhimit të Profilizimit. Duhet të ndahen burimet e duhura financiare për të siguruar zgjidhje të qëndrueshme. Si rezultat i ngjarjeve të viteve 1998-1999 dhe 2004, sipas vlerësimeve, përafërsisht 16,000 PZH në Kosovë janë duke u përballur me vështirësi dhe në pritje të zgjidhjeve afatgjata. Nga familjet shqiptare të PZH-ve të anketuara, zgjidhja e preferuar e përhershme për vendbanimin e tyre është kthimi në vendin e origjinës me 62%. Për dallim nga kjo, për familjet e anketuara rome, ashkali dhe egjiptiane, integrimi lokal në vendin e zhvendosjes ishte opsioni i preferuar me 80%, ndërsa për PZHBV-të serbë, gjithsej 83% e familjeve serbe të anketuara në banesa private dhe 91% në qendrat kolektive do të konsiderohej qëndrimi në vendin aktual të zhvendosjes. Në vitin 2016, UNHCR, së bashku me partnerët lokalë, kreu një vlerësim të nevojave në një mostër prej 1,400 familjesh që kishin shprehur më parë dëshirën për t'u kthyer (mbi 4,600 individë/1,400 familje) të zhvendosura nga Kosova në Mal të Zi, Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe Serbi. Rezultatet e kësaj ankete na tregojnë se më shumë se 90% e PZH-ve janë të interesuar të kthehen.

Duke u përpjekur për të krijuar kushtet më të mira të mundshme për ata që tashmë janë kthyer dhe për ata që kanë shprehur interes për t'u kthyer në Kosovë, MKK, me palët e tjera relevante të interesit, koordinon mbylljen e qendrave kolektive. Gjithashtu, sipas pasqyrës statistikore të nxjerrë nga UNHCR në shkurt të vitit 2023, gjatë dy dekadave të fundit në Kosovë janë kthyer 29,297 persona. Kur këto të dhëna analizohen në baza etnike, vërehet se numri më të madh i të kthyerve i takon komunitetit Serb (12,738), pasuar anëtarët e komunitetit ashkali/egjiptian (7,770) dhe rom (4,077) (shih tabelën 6).

Tabela 6. Kthimi gjatë periudhës 2000-2023 (raporti i UNHCR-së, shkurt 2023)

E.1.	Kthimi vullnetar i komuniteteve jo shumicë																								Total	%
	2000 – 2023																									
	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023		
Shqiptar	0	27	29	24	8	49	53	15	43	86	99	27	67	10	50	20	39	13	43	1	16	21	6	0	1325	4.54
Ashkali/Egjiptian	0	53	88	118	59	72	46	31	19	28	71	39	30	20	15	22	15	15	96	53	76	31	25	8	7770	26.5
Boshnjak	57	0	14	39	47	25	93	89	39	43	49	60	84	40	9	18	11	2	10	0	3	0	1	0	1879	6.4

³¹ <https://www.unhcr.org/see/10865-profiling-of-internally-displaced-people-in-kosovo.html>

Kroat	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	2	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	4	0.0
Goran	3	0	73	14	14	12	13	23	85	90	18	10	89	2	21	23	0	1	5	0	0	0	0	0	1464	5.0
Malazez	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2	9	1	0	1	3	1	0	4	0	0	0	0	0	21	0.1
Romë	20	21	39	28	43	23	30	58	86	21	37	12	13	13	55	85	66	16	35	14	61	47	17	13 4077	13.9	
Serb	18	67	96	155	81	74	61	58	23	43	89	47	37	34	39	42	29	14	13	1	23	26	155	8 127 38	43.5	
Turk	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	1	0	1	0	3	7	6	0	0	0	0	0	0	19	0.1
Totali	19	14	27	380	246	212	166	18	67	11	23	11	10	82	68	80	58	49	32	1	9	36	204	29	292	100.0

*Shqiptar i referohet atyre që janë në situatë minoritare

Siç mund të shihet në tabelën 7, të dhënat e pasqyrës statistikore të nxjerra nga UNHCR në shkurt të vitit 2022 gjithashtu tregojnë se nga 29,297 personat e kthyer vullnetarisht në Kosovë, më së shumti të kthyer ka nga Serbia (16,108) me 10,690 persona nga komuniteti serb, 2098 persona nga komuniteti ashkali dhe egjiptian, 1557 nga komuniteti rom, 1203 nga komuniteti goran dhe 545 nga komuniteti boshnjak. Më pas, rreth 6503 persona janë kthyer brenda Kosovës, respektivisht 2153 persona nga komuniteti ashkali dhe egjiptian, 1826 persona nga komuniteti serb, 1319 nga komuniteti shqiptar, dhe 1098 persona nga komuniteti rom. Vendi i tretë prej së cilit janë kthyer më së shumti PZH është Mali i Zi (3853), prej të cilëve 2137 persona nga komuniteti ashkali dhe egjiptian, 799 persona nga komuniteti boshnjak, 699 persona nga komuniteti rom dhe 173 persona nga komuniteti serb. Në fund vijnë të kthyerit nga Maqedonia e Veriut (1670), shtetet e treta (802) dhe Bosnjë dhe Hercegovina (361) (shih tabelën 7).

Tabela 7. Kthimi vullnetar i komuniteteve jo shumicë sipas etnisë dhe vendit paraprak të zhvendosjes (raporti i UNHCR-së, shkurt 2023)


E.4.	Kthimi vullnetar i komuniteteve jo shumicë sipas etnisë dhe vendit paraprak të zhvendosjes 2000 – 2023						
	Bosnie dhe Hercegovinë	Maqedoni e Veriut	Mali i Zi	Serbia	Shtetet e treta	Brenda Kosovës	Total
Shqiptar*	0	3	0	3	0	1319	1325
Ashkali dhe Egjiptian	98	1019	2137	2098	257	2161	7770
Boshniak	162	17	799	545	301	55	1879
Kroat	0	0	0	2	2	0	4
Goran	41	14	42	1203	143	21	1464
Malazez	0	4	3	9	0	5	21
Romë	53	594	699	1557	76	1098	4077

Serb	7	19	173	10690	23	1826	12738
Turk	0	0	0	1	0	18	19
Total	361	1670	3853	16108	802	6503	29297

*Shqiptar i referohet atyre që janë në situatë minoritare

Të dhënat gjithashtu tregojnë se megjithëse numri më i madh i të kthyerve është arritur gjatë viteve 2002 deri 2010, pas një rënie të përgjithshme të trendit, viti 2020 shënon një rritje të lehtë të numrit të të kthyerve krahasuar me dy vitet paraprake, por pastaj në vitin 2021 dhe 2022 ka sërish rënie të numrit të personave të kthyer, sidomos në vitin 2022 (shih tabelën 8).

Tabela 8. Kthimi gjatë periudhës 2000-2022 (raporti i UNHCR-së, dhjetor 2022)



Siç shihet edhe nga statistikat e lartcekura, kthimi i personave të zhvendosur nga komunitetet jo shumicë në Kosovë mbetet sfidë që nga paslufta, sidomos sa i përket të drejtave të tyre. Vlen të theksohet se sipas një raporti të Departamentit të Shtetit Amerikan, përfaqësuesit parlamentarë të komuniteteve ashkali, egjiptiane dhe rome raportuan se paragjykimet sociale penguan kthimin e afro 400 ashkalive, egjiptianëve dhe romëve, të cilët kanë qenë më parë rezidentë në vend dhe kanë informuar UNHCR-në se ishin gati të ktheheshin nga Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi.³² Deri më tani, partnerë të ndryshëm ndërkombëtar kanë ndihmuar kthimin e PZH-ve nga rajoni në dhe brenda Kosovës përmes projekteve të ndryshme, kryesisht, të financuara nga Instrumenti i BE-së për Para anëtarësim (IPA). Partnerët zbatues të këtyre projekteve ishin UNDP, DRC dhe IOM. Këto projekte në vlerë totale prej 30.5 milion euro, të zbatuara në periudhën kohore 2008-2021, kanë ndihmuar kthimin e rreth 1,004 familjeve në Kosovë (shih tabelën 9). Deri në vitin 2021, MKK në linjën buxhetore të projekteve kapitale për ndërtimin e shtëpive për të kthyerit ka

³² Departamenti i Shtetit Amerikan, Raportet e Vendit për praktikën e të drejtave të njeriut për vitin 2020: Kosova 2020, Byroja për Demokraci, të Drejta të Njeriut dhe Punësim, f. 17.

shpenzuar gjithsej 19,227,923 EUR, ndërsa 1,000,000 EUR janë ndarë për vitin 2022.³³

Tabela 9. Projektet që kanë ndihmuar kthimin vullnetar të Popullsisë së zhvendosur në rajon dhe brenda Kosovës (PZH) (burimi: IOM)

Titulli	CRIS nr.	Periudha kohore	Kontributi i BE-së	Kontributi i MKK-së	# i familjeve të kthyer	Partneri zbatues
BE- Kthimi dhe Riintegrimi në Kosovë – faza I (IPA 2007)	2008/162-519	22 korrik 2008-31 tetor 2010 (27 muaj)	EUR 3.3 M	EUR 1.0 M	181	UNDP
BE- Kthimi dhe Riintegrimi në Kosovë – faza II (IPA 2008)	009/215-276	01 gusht 2009-31 tetor 2011 (27 muaj)	EUR 4.0 M	EUR 1.0 M	214	DRC
BE- Kthimi dhe Riintegrimi në Kosovë – faza III (IPA 2010)	2011/269-936	01 nëntor 2011-31 tetor 2014 (36 muaj)	EUR 4.2 M	EUR 1.0 M	210	IOM
BE- Kthimi dhe Riintegrimi në Kosovë – faza phase IV (IPA 2012)	2014/344-650	01 nëntor 2014-31 korrik 2017 (33 muaj)	EUR 4.0 M	EUR 2.5 M	262	IOM
BE- Kthimi dhe Riintegrimi në Kosovë – faza V (IPA 2016)	2017/391-105	10 nëntor 2017-30 shtator 2023 (71 muaj) – duke vazhduar	EUR 8.0 M	EUR 1.5 M	377	IOM

Duke marrë parasysh se ende nuk janë kthyer të gjithë PZH, Qeveria e Kosovës, e sidomos MKK-ja dhe partnerët e tjerë gjatë zbatimit të kësaj strategjie do të punojnë së bashku me të gjitha sektorët për të siguruar që komunitetet të përfitojnë nga politikat institucionale që sjellin përmirësim të çështjeve që i përkasin arsimit, shëndetësisë, punësimit, sigurisë, etj. MKK dhe partnerët zbatues do punojnë për së afërmi me ministrinë relevante dhe institucionet e nivelit qendror dhe lokal, në mënyrë që të sigurojë se politikat e duhura janë zhvilluar dhe zbatuar. Në funksion të përmirësimit të zbatimit të politikave të të kthyerve, MKK në bashkëpunim me partnerët zbatues duhet që sa më shpejtë të përditësojë të dhënat në databazën ekzistuese.

³³ Shih tabelën 3.2 Projektet kapitale për nivelin qendror të Ligjit Nr. 08/066 për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikën e Kosovës, f. 62, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=51763>

IV.3.2.Arsimi

Përmirësimi i qasjes në arsim për komunitetet jo-shumicë, veçanërisht për grupet më të cenueshme si romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët.

Arsimi në Kosovë është i organizuar nga MASHTI, ku ofron arsim në gjuhët shqipe, turke dhe boshnjake, ndërsa ofrohet po ashtu arsimi në gjuhën serbe në Kosovë. MASHTI ka bërë përpjekje për ta lehtësuar integrimin e komuniteteve jo-shumicë në sistemin e shkollimit në Kosovë, duke ofruar mundësinë e mësimin të gjuhës romë si lëndë zgjedhore, ndërsa në nivelin e arsimit të lartë, MASHTI ka nxjerr Udhëzimin Administrativ për përcaktimin e vendeve të rezervuara për studentët që u përkasin komuniteteve jo shumicë.³⁴ Po ashtu, MASHTI në bashkëpunim me partnerët, REF dhe VORAE, për vitin shkollor 2020/2021 ka ndarë 596 bursa për nxënësit e shkollave të mesme të larta për komunitetet Romë dhe Ashkali. Më 17 mars 2022, Ministrja e MASHTI dhe Ministri i MAPL-së, kanë nënshkruar Memorandumin e Bashkëpunimit për ofrimin e mbështetjes financiare (100 bursa) për studentët e komuniteteve ashkali, egjiptian dhe rom, të cilët studiojnë në universitetet publike në Kosovë.

Tabela 10, jep të dhëna për regjistrimin e fëmijëve/nxënësve të të gjitha komuniteteve në Kosovë në shkollat me kurikulë të Kosovës që ofrohet nga MASHTI sipas niveleve shkollore (parashkollor, parafillor, fillor/i mesëm i ulët, i mesëm i lartë) në arsimin parauniversitar, sipas të cilave marrin pjesë rreth 305.157 shqiptarë, 2.564 turq, 3.388 boshnjakë, 4.195 ashkalinj, 1.325 romë, 1.336 egjiptianë dhe 426 goranë.³⁵ Graf. 1, jep të dhëna për pjesëmarrjen e përgjithshme e nxënësve të përfshirë në arsimin fillor dhe atë të mesëm të ulët, e shprehur në përqindje sipas përkatësisë etnike, është 95.3 % shqiptarë, ndërsa 4.7 % i përkasin grupeve të tjera etnike.³⁶ Në anën tjetër, Graf.2. jep të dhëna për pjesëmarrjen e përgjithshme e nxënësve të përfshirë në arsimin e mesëm të lartë, e shprehur në përqindje sipas përkatësisë etnike, është 97.0 % shqiptarë, ndërsa 3.0 % i përkasin grupeve tjera etnike.³⁷

³⁴ Shih Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr. 09/2016 Aplikimi i masave afirmative dhe vendeve të rezervuara për regjistrim të kandidatëve nga komunitetet jo shumicë në institucionet publike të arsimit të lartë. I qasshëm në: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2016/06/ua-masht-09-2016-aplikimi-i-masave-afirmative-dhe-vendeve-te-rez-al.pdf>

³⁵ Raporti i MASHTI, Statistikat e Arsimit në Kosovë 2020/21, Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim, qershor 2021, f. 28-33, i qasshëm në: <https://ask.rks-gov.net/media/6072/statistikat-e-arsimit-20202021.pdf>

³⁶ Po aty.


³⁷ Po aty.

Tabela 10. Nxënësit sipas përkatësisë etnike dhe niveleve shkollore 2020/21, total


Niveli	Shqiptar	Turk	Boshnjak	Ashkali	Rom	Egjiptian	Goran
Arsimi parashkollor (mosha 0<5)	4,147	6	3	3	4	13	n/a
Arsimi parafillor (mosha 0<6)	19,201	190	194	213	84	61	34
Arsimi fillor/mesëm i ulët	213,112	1781	2,427	3755	1067	1123	386
Arsimi i mesëm i lartë	68,697	587	764	224	170	139	6
Gjithsej	305,157	2,564	3,388	4,195	1,325	1,336	426

(Burimi: Të dhëna nga statistikat vjetore të MASHTI)

Graf. 1. Numri i nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët sipas përkatësisë etnike në %



Graf. 2. Numri i nxënësve në arsimin e mesëm të lartë sipas përkatësisë etnike në %



Në anën tjetër, tabela 11. jep të dhëna sa i përket pjesëmarrjes së mësimdhënësve sipas përkatësisë etnike, ku shihet se në sistemin me kurrikulë të Kosovës janë të angazhuar gjithsej 22.469 shqiptarë, 469 boshnjakë ,199 turq, , 6 ashkalinj, 9 romë, 6 egjiptianë, 6 goranë dhe 8 kroatë. Ndërsa, për komunitetin serb dhe atë malazez, MASHTI nuk posedon të dhëna.

Tabela 11. Mësimdhënësit sipas përkatësisë etnike 2020/21, total

Përkatësi etnike	Shqiptar	Serb	Turk	Boshnjak	Ashkali	Rom	Egjiptian	Goran	Kroat
Gjithsej	22,469	n/a	199	469	6	9	6	6	8

Në vitin 2015, Qeveria e Kosovës nxori Rregulloren nr. 21/2015 për verifikimin e diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut pas vitit 2001 për qëllime të aplikimit për punë, për të marrë licenca profesionale dhe për t'iu nënshtruar provimeve në institucionet publike, gjë që ka lehtësuar qasjen në punësim në Kosovë për shumë të diplomuar nga ky universitet.³⁸ Në total deri në dhjetor 2020 janë verifikuar pozitivisht 1709 diploma. Aktualisht, procesi i verifikimit është i rrezikuar nga mbështetja e pasigurt financiare nga donatorët. Për më tepër, faza e ardhshme e mundshme - njohja e diplomave të shkollave të mesme dhe kolegjeve profesionale, është vendimtare. Njohja e diplomës është e nevojshme si nga niveli universitar ashtu edhe nga shkolla e mesme Kjo është thelbësore për të rritur mundësitë e punësimit në mesin e komuniteteve jo-

³⁸ Shih supra note 27, f. 45. <https://www.osce.org/files/f/documents/d/2/493678.pdf>

shumicë dhe për të mbështetur qasjen në arsim dhe ri integrimin e plotë të pjesëtarëve të serbëve dhe komuniteteve të tjera që ndjekin arsimin në gjuhën serbe (komuniteti serb, rom, goran, boshnjak). Kjo mungesë e njohjes ka një ndikim serioz negativ në mundësitë e punësimit të studentëve dhe pengon ri integrimin e komuniteteve serbe dhe jo serbë në shoqërinë kosovare. Andaj bazuar në këto të dhëna, duhet të funksionalizohet Komisioni për Njohjen e Diplomave të Universitetit të Mitrovicës së Veriut.

Në vitin 2016, me nxjerrjen e Udhëzimit Administrativ Nr. 09/2016 për aplikimin e masave afirmative dhe vendeve të rezervuara për regjistrim të kandidatëve nga komunitetet jo-shumicë në institucionet publike të arsimit të lartë, u përcaktua kuota prej 12% për studentët e komuniteteve jo-shumicë nga numri i përgjithshëm i studentëve të paraparë për pranim.³⁹ Nga viti 2008 deri në vitin 2020, në të gjitha fakultetet e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, janë paraparë 5 mijë e 372 vende për komunitetet jo-shumicë. Pavarësisht këtij numri, gjatë gjithë këtyre viteve vetëm 18.42% e vendeve janë plotësuar me 990 studentë të pranuar nga komunitetet jo-shumicë. Vetëm 23.93% kanë diplomuar nga 990 sa janë pranuar, pra, 237 studentë nga komunitetet jo-shumicë kanë diplomuar në universitet për 12 vite.

Shkalla e vijueshmërisë së nxënësve në arsimin parauniversitar, e ndarë sipas përkatësisë etnike, është relativisht proporcionale me demografinë e Kosovës. Nuk ka të dhëna të ndara sipas përkatësisë etnike dhe gjinisë. Shkalla e braktisjes mund të jetë veçanërisht e lartë për fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës që janë riatdhesuar. Megjithatë, të dhënat për vijueshmërinë e shkollës nga romët e Kosovës, ashkalinjtë dhe egjiptianët e Kosovës të ndara sipas gjinisë nuk janë të disponueshme. Kjo paraqet vështirësi për të kuptuar dallimet mes vajzave dhe djemve.⁴⁰ Shkalla e shkrim-leximit të komunitetet romë, ashkalinj dhe egjiptianë është më e ulët krahasuar me pjesën tjetër të popullsisë. Nga rreth 98% e popullsisë së Kosovës që di shkrim-lexim, vetëm 73% e grave dhe rreth 87% e burrave romë, ashkalinj dhe egjiptianë dinë shkrim-lexim. Në shkallë vendi, pjesëmarrja e rinisë romë, ashkalinj dhe egjiptianë, nga 65% në shkollën e mesme të ulët bie në 30% në shkollën e mesme të lartë.⁴¹

Tabela 12. Krahasimi i numrit të nxënësve që kanë braktisur shkollën ndër vite

Përkatësia etnike	2017/2018	2018/2019	2019/20
Rom dhe Ashkali	88	83	50

(Burimi: Të dhëna nga statistikat vjetore të MASHT)

Tabela 12 tregon për tendencën në rënie në numrin e fëmijëve braktisës mund t'i atribuohet së paku pjesërisht punës së ndërmjetësve të shkollave, qendrave mësimore dhe ekipeve të parandalimit dhe reagimit. Megjithatë, niveli i braktisjes së shkollimit nga këto komunitete mbetet

³⁹ Shih nenin 4 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 09/2016, shih *supra note* 35.

⁴⁰ Nicole Farnsworth, Donjeta Morina, David JJ Ryan, Gresa Rrahmani, Vanessa Robinson-Conlon dhe Iliriana Banjska, “Analiza Gjinore e Kosovës”, Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK): 2018, e qasshme në: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20181003170921410.pdf>

⁴¹ Shih Raportin e Admovere, *Sfidat e Komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë gjatë pandemisë Covid-19*, korrik 2020, Prishtinë, f. 9, i qasshëm në: https://admovere.org/wp-content/uploads/2020/07/Final_-Sfidat-e-komunitetit-rom-ashkali-dhe-egjiptian-ne-kosove-gjate-pandemise-COVID-19-Alb-.pdf

i lartë. Përveç varfërisë, shkaqet e tjera të braktisjes duhet të kërkohen edhe në mungesën e përkrahjes nga prindërit për shkak të vetëdijes së ulët të një numri të konsiderueshëm të tyre, dhe mos vlerësimit të shkollimit nga ana e tyre, hapësirave të papërshtatshme për punë në disa shkolla, numri i madh i nxënësve në klasa, distanca nga shkolla, kushtet ekonomike dhe sociale të familjeve, të cilat janë vetëm disa nga sfidat me të cilat këta nxënës përballen.⁴²

Pra, arsimit i pjesëtarëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës karakterizohet me pjesëmarrje të pakënaqshme në arsimin e detyrueshëm dhe pjesëmarrje shumë të ulët në arsimin e mesëm dhe të lartë.⁴³ Nga numri i përgjithshëm i fëmijëve në arsimin parafillor dhe fillor (të mesëm të ulët), romët e Kosovës, ashkallitë dhe egjiptianët e Kosovës përbëjnë 2.5 për qind (5,808 nxënës nga gjithsej 229,333) sipas të dhënave të mbledhura nga MASHTI për vitin shkollor 2018/19.⁴⁴ Të dhënat e MASHTI tregojnë se 107 Romë të Kosovës, 185 Ashkali të Kosovës dhe 60 fëmijë egjiptianë të Kosovës janë regjistruar si vijues të shkollave parashkollore publike në të njëjtin vit shkollor.⁴⁵

Frekuentimi i ulët i arsimit parashkollor kompensohet disi nga Qendrat Mësimore (QL) në mbarë Kosovën, të cilat ofrojnë shërbime parashkollore, por ende përbëjnë më pak se 20 për qind të fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës.⁴⁶ Pjesëmarrja e ulët në arsimin parashkollor është gjithashtu një problem për nxënësit nga komuniteti shumicë në një komunë të caktuar.

Shkalla shumë e ulët e frekuentimit dhe arritjet akademike të fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës, si dhe mungesa e përfshirjes sociale, çuan në iniciativën e OJQ-ve për themelimin e QM-ve në vitin 2001, me qëllim të ofrimit të shërbimeve arsimore plotësuese. QM-të, si model plotësues i zhvillimit dhe edukimit, ndajnë një synim të përbashkët – të mbajnë fëmijët në shkollë, të lehtësojnë pjesëmarrjen e tyre në arsimin parafillor, fillor dhe të mesëm të ulët dhe të arrijnë rezultate më të mira akademike.⁴⁷ QM-të priren të synojnë zonat e privimit dhe fëmijët që kanë nevojë për mbështetje shtesë për të pasur sukses dhe për të qëndruar në shkollë, të cilat zakonisht janë të papajisura dhe të mbingarkuara.⁴⁸ Gjatë gjithë viteve, QM-të luajtën një rol të rëndësishëm në uljen e numrit të braktisjeve dhe ndikuan pozitivisht në performancën (aftësitë e të lexuarit dhe

⁴² Shih Raportin e Qendrës për Arsim të Kosovës, *Analizë e regjistrimit dhe vijimit të fëmijëve rom, ashkali, dhe egjiptian në klasën e parë dhe klasat parafillore*, 2021, Prishtinë, f.17, i qasshëm në: <http://kec-ks.org/ep-content/uploads/2021/07/Analiza-e-regjistrimit-dhe-vijimit-ne-klasën-e-parë-dhe-klasat-parafillore.pdf>

⁴³ Këshilli i Evropës, “Udhëzime për mësues për përfshirjen sociale të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptiane në shkollë”, 2015, f. 7; i qasshëm: <https://www.coe.int/documents/3843514/13597853/Guidelines-for-teachers-En.pdf/23d76fe4-66d2-4aae-8437-cfcec6bd64d5b>

⁴⁴ Agjencia e Statistikave të Kosovës, “Statistikat Arsimore të Kosovës” 2019/20, Qershor 2020, f. 31; të qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/media/5637/education-201902020-ang.pdf>

⁴⁵ Po aty, f. 28. ASK

⁴⁶ UNICEF, “Zhvillimi i hershëm i fëmijërisë – Një pasqyrë statistikore: Të dhënat për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian”, f.4; e qasshme në: https://www.unicef.org/kosovoprogramme/media/196/file/ECD_Roma_Ashkali_and_Egyptian_communities_ENG.pdf

⁴⁷ KEEN, “Ndikimi i qendrave mësimore në përfshirjen e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë në arsim”, 2018, f. 18, e qasshme në: http://kec-ks.org/wp-content/uploads/2020/08/Ndikimi-i-QMve-ne-Kosove_eng.pdf

⁴⁸ Këshilli i Evropës dhe UNICEF, “Studim mbi Ndikimin dhe Qëndrueshmërinë e Qendrave Mësimore”, 2015, f. 7; 11, e qasshme në: https://www.coe.int/documents/3843514/13597853/Study_on_Impact_and_Sustainability_of_the_Learning_Centers-En.pdf/4a76eefe-21d0-432c-800c-ad234f77f4a2

të shkruarit, notat) e fëmijëve, duke i inkurajuar ata që të vazhdojnë arsimimin e tyre. Një nivel pozitiv kënaqësie u raportua edhe tek prindërit, pasi ata kanë nënvizuar rëndësinë e QM-ve. Në vitin 2018, më shumë se 5,500 fëmijë të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta ndiqnin mësimet plotësuese të ofruara nga QM-të si në shërbimet komunitare ashtu edhe në ato të shkollës. Megjithatë, në vitin 2022, për shkak të pandemisë dhe mbylljes së QM-ve, ky numër ka rënë në pak më poshtë se 3,000. Edhe pse u pranua se QM-të luajnë një rol të rëndësishëm në kontributin në arsimimin e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës, si dhe fëmijëve nga komunitetet e tjera, qëndrueshmëria e tyre ishte në rrezik për shkak të mbështetjes së madhe në donatorët ndërkombëtarë. Prandaj, ka pasur një interesim urgjent që QM-të gradualisht të vendosen nën kujdesin e institucioneve të Kosovës.

Për krijimin e bazës ligjore dhe rregullimin e punës së QM-ve, në dhjetor të vitit 2018, MASHTI nxjerri Udhëzimin e ri Administrativ Nr. 19/2018 (UA Nr. 19/2018) për Themelimin dhe Funkcionimin e Qendrave Mësimore. Kriteret e përcaktuara me këtë udhëzim vendosin kornizën formale për funksionimin e QM-ve të cilat duhet të regjistrohen në MASHTI për të vazhduar ose për të filluar aktivitetet. Me miratimin e mjedisit të punës, kushteve dhe kurrikulës si dhe planit të punës dhe financiar, QM-ve u jepet një leje pune pesëvjeçare me mundësi rinovimi.⁴⁹ Nga ana tjetër, UA Nr. 19/2018 i pajis institucionet e nivelit qeveritar dhe komunal me më shumë përgjegjësi në drejtim të sigurimit të funksionimit dhe financimit efikas dhe të qëndrueshëm të QM-ve. Vonesat, duke përfshirë mungesën e udhëzimeve procedurale, kanë ndikuar ndjeshëm në QM-të ekzistuese dhe shumë janë mbyllur për shkak të përfundimit të projekteve të donatorëve dhe mungesës së financimit. Donatorët ndërkombëtarë që dikur i kanë mbështetur hezitojnë të angazhojnë fonde në vend të palëve përgjegjëse ligjore, dhe ato QM që kanë arritur të sigurojnë fonde nga donatorët kanë vetëm perspektiva financiare konkrete, afatshkurtra ose afatmesme. MASHTI ende nuk ka ndarë mjete adekuate për QM-të dhe disa komuna nuk po e mbështesin institucionalizimin pasi nuk kanë mjete.⁵⁰ Për të funksionalizuar UA Nr. 19/2018 dhe për të mbështetur apo themeluar aktivitetet e QM-ve, MASHTI duhet të ndajë fonde të mjaftueshme vjetore dhe komunat duhet të lejojnë buxhetet e tyre të përfshijnë stafin e qendrës mësimore.

Prandaj, përfshirja e komuniteteve romë dhe ashkali në sistemin arsimor, si dhe braktisja e shkollimit nga pjesëtarët e këtyre komuniteteve, ende mbeten sfida, edhe pse situata është përmirësuar ndjeshëm vitet e fundit. Siç theksohet në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2030, për fëmijët nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptiane, është thelbësore të përmirësohet qasja në të gjitha nivelet e arsimit dhe të promovohet arsimi i strukturuar.

Në fund, mund të thuhet se komunitetet jo-shumicë përballen me shumë sfida integrimin e tyre më nivelet e ndryshme të arsimit në Kosovë, e kjo vlen sidomos për komunitetet romë, Ashkali dhe egjiptiane si grupe më të cënueshme për shkak të kushteve socio-ekonomike të tyre, përderisa komuniteti Serb dhe një pjesë e komuniteteve tjera ende vazhdojnë të ndjekin arsimin në sistemin

⁴⁹ Shih Udhëzimin Administrativ (MASHTI) Nr. 19/2018 për Themelimin dhe Funkcionimin e Qendrave Mësimore, I qasshëm në:
<https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/12/ua-nr-19-masht-per-themelimin-dhe-funksionimin-e-qendrave-mesimore-x.pdf>.

⁵⁰ Në shtator 2021, MASHTI ndau 97,000 euro nga 200,000 euro të premtuara, për tre organizata joqeveritare aplikante të suksesshme, të cilat drejtojnë 22 qendra mësimore. Në prill të vitit 2022, MASHTI hapi thirrje për OJQ-të që menaxhojnë qendrat e regjistruara të mësimin për të aplikuar nga një fond prej 200,000 euro.

serb. Kjo strategji fokusohet në integrimin e komuniteteve jo shumicë në sistemin e MASHTI-it në mënyrë që secilit qytetar të Kosovës t'i mundësohet qasja në arsim të barabartë, e drejtë e garantuar me Kushtetutë.

IV.3.3. Punësimi dhe mirëqenia sociale

Rritja e përfshirjes në skemat e mirëqenies sociale dhe punësimit duhet të jetë me prioritet. Papunësia në Kosovë ka mbetur një nga sfidat kryesore përgjatë viteve jo vetëm për komunitetet jo shumicë në Kosovë por edhe për tërë qytetarët e Kosovës. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (shih tabelën nr. 13), në vitin 2018, shkalla e papunësisë në Kosovë ishte 29.6 përqind, e njëjta ishte ulur në vitin 2019 në 25.7 përqind, ndërsa, rritur lehtë në vitin 2020 në 25.9 përqind.

Tabela 13. Shkalla e papunësisë (%)

Shkalla e papunësisë (%)	2018	2019	2020
Mosha 15-64 vjeç	29.6	25.7	25.9

Neni 9 i Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë përcakton se “Në institucionet publike qendrore, minimum 10% e vendeve të punës në të gjitha kategoritë e zyrtarëve publikë duhet të plotësohen nga pjesëtarët e komuniteteve, të cilat nuk janë shumicë në Kosovë dhe që përmbushin kriteret e pranimit, ndërsa në nivelin komunal, plotësimi i numrit të vendeve të punës për pjesëtarët e komuniteteve bëhet në pajtim me përqindjen e popullatës në atë komunë”.⁵¹ Këtë kuotë, e ka përcaktuar edhe ligji paraprak, respektivisht, Ligji 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës që nga viti 2010. Rregullorja Nr. 04/2010 për Procedurat e përfaqësimit të drejtë dhe proporcional të komuniteteve jo shumicë në shërbimin civil të Kosovës parasheh që institucionet duhet të zbatojnë së paku gjashtë (6) nga katërbëdhjetë (14) masat e veprimit pozitiv, të parapara aty, që përfshijnë: komunikimin; programin për veprim pozitiv, praktikën në punë, bursat, dhe programet e trajnimit për aplikuesit, trajnimet për shërbyesit civil të komuniteteve jo shumicë; punëtoritë kundër diskriminimit; dhe bashkëpunimin ndër-institucional.⁵² Vlen të theksohet se kjo rregullore ka bazën ligjore në ligjin e shfuqizuar të shërbimit civil. Deri më tani, kjo rregullore ende nuk është zëvendësuar me rregulloren e re me bazë në ligjin e ri për zyrtarët publikë. Në rast kontestesh në konflikt administrativ, gjykatat e rregullta mund ta konsiderojnë të njëjtën të shfuqizuar, gjë që rrezikon sigurinë juridike të palëve përfituese nga kjo rregullore.

Sipas një raporti të OSBE-së të vitit 2017, serbët e Kosovës e përbëjnë shumicën dërrmuese të pozitive të plotësuara nga komunitetet joshqiptare në institucionet e nivelit qendror që i janë nënshtruar vlerësimit, të përcjellë nga turqit e Kosovës dhe boshnjakët e Kosovës, ndërsa komunitetet e tjera janë të nën-përfaqësuara në krahasim me përqindjen e tyre në popullsinë e

⁵¹ Shih nenin 9 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=25839>

⁵² Shih nenin 11 të Rregullores Nr. 04/2010 për Procedurat e përfaqësimit të drejtë dhe proporcional të komuniteteve jo shumicë në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, e qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8290>

Kosovës⁵³. Komisioni Evropian ka vlerësuar se punësimi i komuniteteve jo-shumicë në sektorin publik ende bie nën pragun prej 10% të përcaktuar me dispozitën e lartcekur, andaj këto komunitete mbeten përgjithësisht të nën përfaqësuar në shërbimin civil si në nivel qendror ashtu edhe në atë komunal.⁵⁴ Ndërsa, për sektorin privat mungojnë të dhëna të përditësuara.

Shkalla e lartë e papunësisë prekë të gjitha nivelet e popullatës; sidoqoftë, ajo prekë në mënyrë disproporcionale komunitetet jo-shumicë dhe përkeqëson edhe më tej situatën e tyre shpesh të vështirë sociale-ekonomike, veçanërisht atë të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptiane.⁵⁵ Sipas Raportit të BE-së për Kosovën për vitin 2021, anëtarët e këtyre komuniteteve zakonisht punojnë në sektorin joformal, punë të rrezikshme, të pasigurta, të përkohshme, me gjysmë orari, me status të ulët (kryesisht punë fizike që nuk kërkojnë shkathtësi të larta), si dhe pak prej tyre janë të regjistruar si të papunë. Sipas këtij raporti, vetëpunësimi është rritur lehtë në 22.1 përqind në vitin 2020 krahasuar me 21.6 përqind në vitin 2019.⁵⁶ Po ashtu, për anëtarët e rinj të këtyre komuniteteve, këto sfida përforcohen më tej nga mosha e tyre e re, duke rezultuar në marginalizim serioz dhe përjashtim nga tregu i punës.⁵⁷

Sipas Raportit të ish Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejshëm: MPMS) për vitin 2018, 95.890 persona nga të gjitha komunitetet janë regjistruar si të papunë, me shqiptarët që përbëjnë pjesën më të madhe (83.6 përqind), ndjekur nga serbët (7.7 përqind); ndërsa romët (1.8 përqind), ashkalitë (2.8 përqind) dhe egjiptianët (0.9 përqind) të cilët përfaqësojnë një pjesë të vogël të numrit të përgjithshëm të të papunëve të regjistruar. Mirëpo, nëse i vendosim në perspektivë, këto shifra tregojnë se 20 përqind e popullsisë së përgjithshme të komunitetit rom, 17 përqind e komunitetit ashkali dhe 7 përqind e popullsisë së përgjithshme të komunitetit egjiptian (bazuar në regjistrimin e popullatës të vitit 2011) ishin regjistruar të papunë; për dallim, 5 përqind e popullsisë së përgjithshme shqiptare ishin regjistruar si të papunë. Për komunitetin boshnjak, shifrat janë 6 dhe 9 përqind, përkatësisht, dhe për komunitetin turk 3 dhe 4 përqind.⁵⁸

Siç parashihet në Ligjin Nr. 05/L -077 për Regjistrimin dhe Ofrimin e Shërbimeve për të Papunët, Punëkërkuesit dhe Punëdhënësit, përmes Rregullores (MPMS) NR. 01/2018 për Masat Aktive të Tregut të Punës, ish MPMS, tani Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (në tekstin e mëtejshëm: MFPT) për punëkërkuesit e regjistruar në Zyrat e Punësimit, ofron shërbime këshillimi, ndërmjetësim në punë, trajnime profesionale dhe pjesëmarrje në skema të ndryshme të masave aktive të tregut të punës (p.sh. subvencionim page, praktikë në punë, projekte për punësim sezonal, grante për fillim biznesi, etj.), dhe informata për migrim me qëllim të punësimit të rregullt. Sigurimi i pjesëmarrjes në masat aktive të tregut të punës (MFPT) për komunitetet jo shumicë zakonisht sigurohet përmes kuotës për këto komunitete, në kuadër të skemave të MFPT. Sipas të dhënave të vitit 2018 të tani MFPT-së, nga 3,764 ndërmjetësime të rregullta të punësimit të kryera,

⁵³ Raport i OSBE-së, Përfaqësimi i komuniteteve në Shërbimin Civil të Kosovës, maj 2017, f. 13, i qasshëm në: <https://www.osce.org/files/f/documents/8/6/320522.pdf>

⁵⁴ Komisioni Evropian, Raporti i BE-së për Kosovë për vitin 2021, f. 36, i qasshëm në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021_en

⁵⁵ Shih *supra* note 27, f. 52. Raportin e OSBE-së, *Raport për vlerësimin e të drejtave të komuniteteve*, qershor 2021

⁵⁶ Shih *supra* note 53, f. 88. (Raporti i BE-së për Kosovë për vitin 2021)

⁵⁷ Shih Raportin e ILO, *Promovimi i mundësive të dinjtetshme për punë për rininë romë, ashkallie dhe egjiptiane*, Prishtinë, 2017, f.19 i qasshëm në: https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/publication/wcms_619034.pdf

⁵⁸ Shih *supra* note 27, f. 53 (<https://www.osce.org/files/f/documents/d/2/493678.pdf>)

në 91.1 përqind të rasteve pjesëtarët e komunitetit shqiptar ishin përfitues, ndërsa pjesëtarët e secilit komunitet jo-shumicë përbënin më pak se dy përqind të numrit të përgjithshëm të përfituesve.⁵⁹ Në përgjithësi, 5.497 persona kanë vijuar trajnime profesionale, ku shqiptarët përbënin 95.8 përqind të tyre, ndërsa pjesëmarrja e pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë ishte jashtëzakonisht e ulët.⁶⁰

Me Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr.02/L-17, është e përcaktuar dhe rregulluar roli dhe përgjegjësitë e MD, Komunës, Qendrës për Punë Sociale, sektorit jo-qeveritar dhe Këshillit të Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare.

MD është përgjegjëse për organizimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare në Kosovë dhe siguron që të gjithë banorët e Kosovës të kenë qasje të barabartë në shërbimet sociale dhe familjare pa dallim. Po ashtu, ministria është përgjegjëse për zhvillimin e politikave, hartimin e legjislacionit, standardeve, planeve strategjike për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për popullatën e Kosovës si dhe siguron zbatimin e duhur nga ana e komunave dhe organizatave të tjera që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare.

Shërbimet sociale ofrohen kryesisht në nivel lokal. Komponentët kryesore të sistemit të ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare në nivel lokal përfshijnë Drejtoritë Komunale të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Qendrat për Punë Sociale (QPS), institucionet rezidenciale, si dhe rrjetin e OJQ-ve të zhvilluara për të mbështetur grupet e cenushme.

Programi për Stabilizim të Komuniteteve (EU-CSP) është një program i financuar nga BE dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK) dhe zbatohet nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) që nga viti 2010. Programi EU-CSP kontribuon në stabilizimin e komuniteteve jo-shumicë duke lehtësuar qasjen e tyre në komunitet me mundësi ekonomike dhe duke mundësuar krijimin e mjeteve të qëndrueshme të jetesës duke përmirësuar njëkohësisht kushtet e jetesës në zonat me popullatë jo-shumicë. Përmes këtyre veprimeve, programi synon të përmirësojë kushtet për pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë për të qëndruar në Kosovë dhe të inkurajojë ata që janë larguar të kthehen. Programi për Stabilizim të Komuniteteve (EU-CSP) është krijuar për të adresuar nevojat e popullatë jo-shumicë për të gjeneruar të ardhura dhe për të përmirësuar kushtet e tyre të jetesës. Ndihma ofrohet përmes ofrimit të granteve dhe asistencës teknike për pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë në themelimin e bizneseve të vogla dhe iniciativave për përmirësimin e komunitetit dhe shoqatave/kooperativave të biznesit. Programi EU-CSP ka mbështetur mbi 700 biznese të vogla (të reja dhe ekzistuese) në zonat e synuara dhe janë mbështetur dhe realizuar mbi 220 projekte të zhvillimit të komunitetit dhe 16 shoqata/kooperativa biznesi. Janë krijuar dhe siguruar mbi 1000 vende pune (me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme/sezonale) me synim të veçantë punësimin e grave dhe të rinjëve dhe grupeve më të ndjeshme sikurse komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian.

Programi gjithashtu ka ndikuar pozitivisht mbi 100,00 individë si anëtarë të familjeve përfituese, të punësuar dhe anëtarë të komunitetit më të gjerë. Raporti final i evaluimit të këtij projekti ka vlerësuar se Programi EU-CSP ka demonstruar një nivel të jashtëzakonshëm efektiviteti: 100% e

⁵⁹ Po aty. (<https://www.osce.org/files/f/documents/d/2/493678.pdf>)

⁶⁰ Po aty. (<https://www.osce.org/files/f/documents/d/2/493678.pdf>)

përfitueseve që janë vizituar drejtojnë efektivisht një biznes të qëndrueshëm dhe 100% e projekteve për komunitetet përdoren rregullisht nga komunitetet.⁶¹ Vlen të theksohet se ky program, respektivisht faza IV e saj gjendet edhe në faqen 25 të Programit të Qeverisë së Kosovës për vitet 2021-2025, ku i njejti konsiderohet si projekt për krijimin e të ardhurave dhe mundësive të punësimit në mesin e komuniteteve jo-shumicë në të gjitha rajonet, dhe përfshirjen sociale dhe stabilizimin e përgjithshëm të komuniteteve në Kosovë.

Komunitetet do të mbështeten drejt zhvillimit ekonomik dhe integritit kulturor dhe social përmes projekteve që kanë për qëllim kthimin, ri integrimin dhe stabilizimin e komuniteteve, si dhe mbështetjen financiare të shoqërisë civile me qëllim të krijimit të besimit të ndërsjellë ndërmjet komuniteteve, përmes programit EU CSP që synon krijimin e të ardhurave dhe mundësive të punësimit në mesin e komuniteteve pakicë në të gjitha rajonet, dhe përfshirjen sociale dhe stabilizimin e përgjithshëm të komuniteteve në Kosovë.

Pavarësisht, kornizës së konsoliduar ligjore dhe mekanizmave të krijuar, një nga pesë shtetas të Kosovës konsiderohet i varfër sipas statistikave zyrtare, i cili përballet me vështirësi për t'u qasur në shërbimet bazike, duke përfshirë qasjen në shërbimet shëndetësore dhe në arsim.⁶² Po ashtu, shkalla e lartë e papunësisë përcillet edhe me numër të madh të përfituesve nga skemat sociale. Në mars të vitit 2019, 205 familje të komunitetit romë, 833 familje të komunitetit ashkali, dhe 430 familje të komunitetit egjiptian pranuan ndihmë sociale.⁶³ Më 2018, krahasuar me familjet jorome, 29% më shumë prej familjeve rome kishin nga një person që shkonte në shtrat i uritur. Krahasuar me familjet jorome në afërsi të tyre, familjet rome kanë 17% më pak qasje në banjë nëpër banesat e tyre; 10% më pak përdorin shërbimet shëndetësore parandaluese; 23% më pak të rinj janë të përfshirë në punësim, arsim ose trajnim.⁶⁴ Përfshirja e ulët e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane në skemat e mirëqenies sociale dhe shfrytëzimi i pamjaftueshëm i shërbimeve sociale vështirëson zbutjen e varfërisë në mesin e këtyre komuniteteve dhe kjo paraqet sfida shumë serioze.

IV.3.4. Strehimi

Strehimi është një e drejtë e njeriut që garantohet me nenin 25 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, e cila është drejtpërdrejtë e zbatueshme në Kosovë përmes nenit 22 të Kushtetutës. Në funksion të realizimit të kësaj të drejte, Qeveria në mbledhjen e saj të 121-të, në ka miratuar Programin Legjislativ për vitin 2023 ku përfshihet edhe Projektligji për Banim Social, i propozuar nga Ministria për Mjedis, Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturë,⁶⁵ i cili synon të rregullojë “... kushtet dhe mënyrën e realizimit të së drejtës për banim social, procedurat e

⁶¹ Thomas Vasseur, Basil Henry, *Raporti final i Evaluimit të Programit për Stabilizim të Komuniteteve (EU-CSP)* Kontrata kornizë e përfituesve 2013 – Lot 7, Kontrata Nr. 2017/388942, dhjetor 2017, f. 6.

⁶² Shih studimin e Bankës Botërore, *Studimi i vlerësimit të Asistencës Sociale të Kosovës, opsionet e reformave*, Uashington, mars 2019, f. 10, i qasshëm në: <https://documents1.worldbank.org/curated/en/994991557470271998/pdf/Kosovo-Social-Assistance-Scheme-Study-Assessment-and-Reform-Options.pdf>

⁶³ Shih *supra* note 27, f. 54. (<https://www.osce.org/files/f/documents/d/2/493678.pdf>)

⁶⁴ Shih *supra* note 40, f. 12.

⁶⁵ Shih Programin Legjislativ për vitin 2022, i qasshëm në: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/10/Programi-Legjislativ-per-vitin-2022-03.10.2022.pdf>

qiramarrjes, qiradhënies, administrimin dhe menaxhimin e ndërtesave për banim social”⁶⁶. Projektligji në fjalë rregullon procedurat me anë të së cilave siguron banimin për shfrytëzuesit e ndihmës sociale, familjeve apo individëve me të hyra të ulëta dhe të mesme, të cilët për shkaqe ekonomike dhe sociale nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit.

Deri më tani, ky problem është adresuar në nivel komunal përmes Ligjit Nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta për Banim, i cili ka për qëllim “... krijimin e kushteve për banim të qëndrueshëm për familjet ose individët të cilët nuk janë në gjendje ekonomike t’i përballojnë ofertat e tregut të lirë të banesave si dhe caktimi i mënyrës së sigurimit dhe shfrytëzimit të mjeteve financiare për zhvillimin e programeve të veçanta të banimit”. Sipas këtij ligji, administrimi i banesave me qira përmes këtyre programeve është kompetencë e organit kompetent komunal ndërsa mirëmbajtja kryhet nëpërmjet kontraktimit të personave juridik të licencuar nga Ministria përgjegjëse për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.⁶⁷ Ky ligj parasheh që “organet kompetente komunale hartojnë programe tre (3) vjeçare të banimit për popullsinë që kanë nën juridiksionin e tyre, duke u mbështetur në analizën e nevojave për banim, sipas parashikimeve të këtij ligji, të cilat miratohen nga Kuvendi Komunal përkatës”.⁶⁸ Në këtë drejtim, Komuna e Lipjanit ka publikuar Programin trevjeçar për Banim. Sipas Qendrës për Punë Sociale në Lipjan janë të regjistruar 1,276 familje në skema sociale që marrin ndihmë sociale, prej të cilave 1021 familje nga komuniteti shqiptar, 151 nga komuniteti ashkali, 25 nga komuniteti rom, 10 nga komuniteti serb, 8 nga komuniteti kroat, 2 nga komuniteti boshnjak dhe 2 nga komuniteti egjiptian (shih tabelën 14). Një nga kategoritë e synuara nga ky program janë edhe komunitetet ashkali dhe rome, siç mund të shihet edhe nga numri i madh i familjeve që janë përfitues nga skemat sociale.⁶⁹ Pra, përmes programeve dhe masave të tilla në nivel qendror dhe komunal realizohet e drejta për banim/strehim edhe për komunitet jo shumicë, me fokus të veçantë komunitetet rome dhe ashkali, të cilët kryesisht janë përfitues të skemave sociale.

⁶⁶ Shih nenin 1 të Projektligjit për Banim Social, version i publikuar në platformën qeveritare për konsultime publike në vitin 2019, i qasshëm në: <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=40775>

⁶⁷ Shih nenin 8 të Ligjit Nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta për Banim, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2670>

⁶⁸ Po aty, shih nenin 20.

⁶⁹ Shih Programin Trevjeçar të Komunës së Lipjanit për Banim 2022-2025, i qasshëm në: <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41474>

Tabela 14: Struktura nacionale e familjeve dhe e anëtarëve të familjes që janë përfitues të skemave sociale në Komunën e Lipjanit

Nacionaliteti	Nr. Familjeve	%	Nr. Anëtarëve	%
- Të tjera -	2	0.09%	7	0.13%
Ashkali	151	13.77%	798	14.31%
Boshnjak	2	0.26%	4	0.07%
Egjiptian	2	0.24%	7	0.13%
Kroat	8	0.82%	30	0.54%
Rom	25	1.60%	109	1.96%
Serb	10	0.92%	34	0.61%
Shqiptar	1021	82.29%	4586	82.26%
TOTAL:	1221		5575	

Vëmendje të veçantë për realizimin e të drejtës për banim kanë të kthyerit më cenueshmëri, komunitetet jo shumicë që ende mbeten pa zgjidhje. Duke u përpjekur që të krijohen kushte sa më të mira për të kthyerit si dhe për ata që kanë shprehur interesim që të kthehen në Kosovë, MKK-ja së bashku me akterët e tjerë relevant është duke koordinuar mbylljen e strehimoreve kolektive.. Sipas të dhënave të UNHCR-së, të dhjetorit 2021, 15 strehimore kolektive strehojnë 57 familje me 139 individë. Strehimoret kolektive janë të shpërndara në Mitrovicën e Veriut, Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Zveçanit Në këto strehimore jetojnë refugjatë (3 familje me 3 individë), pjesëtarë të komunitetit Serb (49 familje me 101 individë) si dhe të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian (5 familje me 35 individë) (shih tabelën 15).

Tabela 15: Popullata e refugjatëve dhe PZhBV-ve në strehimoret kolektive (raporti i UNHCR-së, shkurt 2023)

C.2.		Strehimoret kolektive									
Rajoni	Komuna	Refugjatë		K/Serb PZhBV		K/Rom, Ashkali dhe Egjiptian PZhBV		K/Shqiptar PZhBV		Totali	
		Fam	Ind	Fam	Ind	Fam	Ind	Fam	Ind	Fam	Ind
Mitrovicë/ Mitrovica	Mitrovica/ Mitrovica e Veriut	0	0	16	21	0	0	0	0	16	21
	Leposavić/ Leposaviq	3	3	21	45	2	23	0	0	26	71
	Zubin Potok	0	0	6	20	0	0	0	0	6	20
	Zvečan/Zveçan	0	0	6	15	3	12	0	0	9	27
Total: 15 strehimore kolektive në Kosovë		3	3	49	101	5	35	0	0	57	139

Në vitet 2021 dhe 2022, janë ndërtuar gjithsej 72 (37 + 35 respektivisht) shtëpi në kuadër të komponentës së banimit të projektit “BE-Kthimi dhe Ri integrimi në Kosovë-Faza V” (EU-RRK V). Në periudhën 2018 - 2021, si pjesë e projektit “Përballja me trashëgiminë e konfliktit në Kosovë dhe Serbi – Rezultati 2, ishin 23 familje të kthyer dhe 7 komponentë balancues (komuniteti pranues) që janë asistuar me MSRA. Nga 23 familje të kthyer, 10 prej tyre janë asistuar me grante për krijimin e të ardhurave Ndryshe, në mungesë të mbështetjes nga programet e disponueshme të kthimit, një familje rome përfitoi ndihmë për strehim nga diaspora. Përveç kësaj, BE-ja dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim bashke financuar projektin “Mbështetja e zgjidhjeve të qëndrueshme për banorët e qendrave kolektive në Kosovë” në Brezovicë, komuna e Shtërpçës, i cili u zbatua nga DRC. Janë ndërtuar pesë (5) ndërtesa banimi me 110 njësi banimi për personat e zhvendosur dhe familjet në nevojë. Gjithsej 143 PZHBV-të serbë kanë gjetur zgjidhje të qëndrueshme për strehim në vitin 2021 përmes këtij projekti.⁷⁰

Gjithashtu, si pjesë e “Përkrahjes së zgjidhjeve të qëndrueshme për banorët e qendrave kolektive në Kosovë Faza II”, 21 persona serbë të zhvendosur brenda vendit në Bergen, Graçanicë/Gračanica kanë përfituar nga banesat sociale të rinovuara. Projekti është bashkëfinancuar nga BE-ja dhe MKK-ja dhe është implementuar nga DRC. Si pjesë e të njëjtit projekt, janë në proces procedurat e tenderimit për ndërtimin e edhe të dy ndërtesave të banimit në komunën e Leposaviqit janë në proces. Komisioni Qendror Shqyrtues në vitin 2021 është mbledhur për të shqyrtuar rastet që kanë

⁷⁰ Organizata “Advancing together”, *Sfidat e Qëndrueshmërisë dhe Riintegritimit të të Kthyerve/PZhBV-ve*, f. 5, nëntor 2021, i qasshëm në: <https://advancing-together.org/reports/ENG%20-%20Sustainability%20and%20Reintegration%20Challenges%20Report%20November%202021.pdf>

të bëjnë me projektin e banimit “BE-Kthimi dhe Riintegrimi në Kosovë – Faza V” (RRK V), ku ka miratuar gjithsej 50 raste.⁷¹

Gjithashtu, në vazhdimësi të projektit, nga mbyllja e qendrës kolektive “Padalishtë” në Komunën e Graçanicës do të përfitojnë: 17 familje të qendrës kolektive Padalishtë, 5 familje të kthyer nga Maqedonia e Veriut dhe 12 familje në nevojë dhe të mbështetura nga skema e ndihmës sociale. të kësaj komune. Në total nga ky projekt do të përfitojnë 34 familje. Përveç strehimit, këto familje do të mbështeten edhe me mobilje, elektroshtëpiake, ushqimore, produkte joushqimore dhe do të mund të aplikojnë për mbështetje ekonomike.⁷²

Përmirësimi i infrastrukturës së rrugëve, furnizimit me ujë, menaxhimit të ujërave të zeza, etj. MKK-ja ka financuar edhe projekte të infrastrukturës në periudhën 2014-2018. Meqenëse pjesa më e madhe e fondeve janë alokuar për aktivitetet për banim, ndërsa pjesa tjetër e fondeve të mbetura është investuar në projekte që nuk kanë të bëjnë me ndërtimin e shtëpive, siç janë ndërtimi i rrugëve, ndërtimi i objekteve sportive dhe rregullimi i sistemeve të ujit dhe të ujërave të zeza. MKK, gjatë periudhës 2014-2018, ka ndihmuar komunitete të ndryshme në gjithë Kosovën përmes shoqërisë civile. Me iniciativat e organizatave joqeveritare, MKK-ja ka financuar 111 projekte në fushën e arsimit, kulturës, sportit, ngjarjeve fetare dhe shumë fusha të tjera të rëndësishme për cilësinë e jetës së qytetarëve. Fonde u caktuan gjithashtu për 122 projekte për persona fizik dhe 198 projekte për persona juridik, me qëllim të promovimit, stabilizimit dhe ri-integrimit të komuniteteve, kthimit të qëndrueshëm, forcimit të qëndrueshmërisë ekonomike, promovimit të dialogut, tolerancës dhe bashkëjetesës në Kosovë. Gjatë kësaj periudhe, MKK-ja siguroi material ndërtimor për familjet dhe komunitetet e kthyer, për stabilizimin, ri-integrimin dhe qëndrueshmërinë e tyre. Kjo formë e ndihmës në komunitet u mundësoi familjeve që nuk kishin mundësi financiare për të rindërtuar shtëpinë e tyre të krijojnë kushte për një jetë më të mirë. Grantet jepen në formën të materialit ndërtimor, në varësi të nevojave të përfituesve. Kërkesat u aprovuan nga një komision i posaçëm i ngritur nga MKK-së sipas kriterëve të konfirmuara më parë. Përfituesit e këtij lloji të asistencës janë familjet në gjendje të vështirë sociale në të gjithë Kosovën, nga të gjitha rajonet, shtëpitë e të cilëve domosdoshmërisht duhen rindërtuar.

IV.3.5. Çështjet pronësore

Midis 2014 dhe 2018, Personat e Zhvendosur Brenda Vendit (PZHBV) si dhe personat e zhvendosur në rajon (PZHR) vazhdojnë të përballen me sfida në ushtrimin e të drejtave të tyre të pronës dhe banimit.⁷³ Problemet kryesore të identifikuara përfshijnë uzurpimin e pronave, mosekzekutimin e urdhrave nga skema e kompensimit nga Agjencia e Krahasimit dhe Verifikimit të Pronave të Kosovës (AKKVP) si dhe qasjen e kufizuar në banim të qëndrueshëm social dhe

⁷¹ Po aty.

⁷² Inputi i DRC përmes komenteve në formë elektronike, 12 maj 2022.

⁷³ Shih Raportin e OSBE-së, *Vlerësim i Procesit të Kthimit Vullnetar në Kosovë*, 2019, i qasshëm në: <https://www.osce.org/files/f/documents/d/f/440741.pdf>

alokimin e tokës për shfrytëzim në projektet e kthimit.⁷⁴ Po ashtu, ndër pengesa kryesore ndërlihet pashmangshmërisht me faktin që mandatet e AKKVP dhe paraardhësve të saj lejonin dëbimin nga pronat e ri uzurpuara vetëm dy herë, ndërsa kishte raste kur pronat e njëjta ishin ri uzurpuar disa herë.⁷⁵

Është vërejtur përparim në adresimin e të drejtave pronësore të komuniteteve jo-shumicë dhe personave të zhvendosur me miratimin e Strategjisë së Kosovës për të Drejtat Pronësore më 2016. Strategjia përmban një kapitull të veçantë mbi të drejtat pronësore të personave të zhvendosur dhe kërkon që institucionet të respektojnë konventat ndërkombëtare dhe protokollet e tyre. Plani i Veprimit trevjeçar për zbatimin e Strategjisë është miratuar për periudhën 2017-2019 me listën e aktiviteteve specifike dhe institucioneve përkatëse për zbatim. Sipas MD-së, 27% e detyrave në planin e mëparshëm të veprimit janë realizuar plotësisht, ndërsa puna për gati 60% të detyrave të mbetura është duke u zhvilluar.

Më konkretisht, Strategjia identifikon çështje urgjente në lidhje me ushtrimin e të drejtave pronësore nga pjesëtarët e komunitetit dhe PZHBV-të dhe ofron udhëzime adekuate për t'i zgjidhur ato. Çështje të tilla përfshijnë zbatimin e vendimeve për heqjen e uzurpatorëve të paligjshëm dhe njoftimin e PZHBV-ve, sigurimin e ndihmës juridike falas për PZHBV-të dhe të kthyerit, përjashtimin e tarifave gjyqësore, zbatimin e plotë të Ligjit për përdorimin e gjuhëve për t'iu mundësuar pronarëve të pasurive të kërkojnë dhe marrin dokumente në gjuhën e tyre, zgjidhjen e rasteve të transaksioneve mashtruese dhe tatimit të akumuluar të pasurive të patundshme, regjistrimin e të gjitha vendimeve në kadastër, ndarja e tokës për projekte në lidhje me procesin e kthimit dhe harmonizimi i Strategjisë për vendbanimet joformale me dispozitat e Ligjit përkatës për planifikimin hapësinor.⁷⁶

Pavarësisht nga iniciativat e ndërmarra përkitazi me të drejtat pronësore, çështja e ri-uzurpimit të pronës vazhdon të ndikojë negativisht në ushtrimin e të drejtave të pronës nga pjesëtarët e komunitetit, përfshirë PZHBV-të. Në raste të tilla, parashtruesit e kërkesave duhej t'i nënshtroheshin procedurave të gjata gjyqësore në mënyrë që të lirojnë pronën e tyre nga uzurpatori, pasi AKKVP, siç është cekur më lart, mund të bënte vetëm dy dëbime bazuar në rastet. Revokimi i autoritetit të AKKVP për të menaxhuar pronën dhe për të kryer dëbime të shumëfishta pas dy rasteve të uzurpimit u vlerësuan si një shkelje e mundshme e të drejtave pronësore nga Institucioni i Avokatit të Popullit.⁷⁷ Përfundimi i administratës nën mbikëqyrjen e AKKVP do të krijonte një situatë në të cilën këto pasuri nuk do të kishin mbrojtje, pasi asnjë institucion në Kosovë nuk do të mund ta merrte atë përgjegjësi. Si pasojë, prona e PZHBV-ve do të bëhet e cënueshme dhe incidentet e uzurpimeve do të mund të rriten. Kufizimi në vetëm dy dëbime nuk do t'u siguronte mbrojtje të mjaftueshme palëve të prekura, pasi një pjesë e pronës së PZHBV-së u uzurpua përsëri.

⁷⁴ Shih Raportin e OSBE-së, *Mekanizmi i Shqyrtimit të Kërkesave në Masë për të Drejtat Pronësore: Përvoja e Kosovës*, qershor 2020, f. 13, i qasshëm në: <https://www.osce.org/files/f/documents/8/0/454182.pdf>

⁷⁵ Po aty. <https://www.osce.org/files/f/documents/8/0/454182.pdf>

⁷⁶ Shih Strategjinë për të Drejtat Pronësore 2016, Qeveria e Republikës së Kosovës, e qasshme në: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/2EB649CB-988B-4F74-86ED-926CDE060F0B.pdf>

⁷⁷ Shih Raportin *Ex-officio* të Avokatit të Popullit në Rastin Nr. 551/2017, Raport me Rekomandime në lidhje me Heqjen e kompetencave të caktuara të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, sipas Ligjit Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, 19 tetor 2017, i qasshëm në: https://www.oik-rks.org/wp-content/uploads/old_doc/Raport_me_rekomandim551-2017_29973.pdf

Kështu, më 19 tetor 2017, Institucioni i Avokatit të Popullit lëshoi një raport mbi heqjen e disa kompetencave të AKKVP-së, në përputhje me Ligjin Nr. 05/Z-010 për AKKVP, duke u rekomanduar institucioneve kompetente ndryshimin e Ligjit për AKKVP në mënyrë që të mundësohet vazhdimi i menaxhimit të pronës dhe mundësia e dëbimeve shtesë pas çdo ri-okupimi të pronës. Projektligji në fjalë është hartuar nga Zyra e Kryeministrit në përputhje me rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe është miratuar nga Qeveria më 22 shtator 2021. Pritet miratimi nga Kuvendi i Kosovës.

Sa i përket mandatit të AKKVP-së për të zbatuar vendimet e lëshuara nga ish-Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore, që nga dhjetori 2016, AKKVP nuk ka qenë në gjendje të zbatojë një skemë kompensimi për të ashtuquajturat pretendime të Kategorisë A dhe C dhe të zbatojë kërkesat për rrënim të objekteve të ndërtuara pa leje, përkundër faktit se 30,000 euro ishin ndarë për atë qëllim.⁷⁸ Në të dy rastet, Gjykata Kushtetuese vendosi që AKKVP-ja ishte përgjegjëse për zbatimin e këtyre vendimeve sepse kishte një ndikim serioz në të drejtat pronësore të PZHBV-ve dhe urdhëroi AKKVP-në të merrte masa për t'i zbatuar ato. Po ashtu, Gjykata Kushtetuese ka gjykuar se moszbatimi i këtyre vendimeve dhe dështimi i autoriteteve kompetente për të siguruar mekanizma efikas për zbatimin e vendimeve të formës së prerë është në kundërshtim me parimet e sundimit të së drejtës dhe prandaj përbën shkelje të drejtave themelore të njeriut që garantohen me Kushtetutë.⁷⁹ Në janar 2019, AKKVP kontraktoi një kompani private për të rrënuar ndërtesat e ndërtuara në mënyrë të paligjshme. Kur bëhet fjalë për çështjen e PZHV-ve pa pronë, alokimi i tokës që është në pronësi të komunave për të adresuar nevojat për banim të PZHBV-ve mbetet problem për një numër komunash. Vetëm disa komuna iu përgjigjën pozitivisht projekteve të lidhura me kthimin duke alokuar tokë që është në pronësi të komunave për familjet e zhvendosura që nuk kanë tokë, por ka akoma disa sosh që nuk kanë qenë në gjendje t'i përmbushin kërkesat e tilla.

Në vitin 2019, u miratua Ligji i ri Nr. 06 / L- 092 për ndarjen në përdorim dhe shkëmbimin e pronës së paluajtshme komunale. Ky ligj parashikon që prona komunale të jepet për qëllime të strehimit social dhe jo për raste individuale, andaj si i tillë ligji në fjalë e pengon zgjidhjen e strehimit të qëndrueshëm për të zhvendosurit ose personat dhe familjet e kthyer që mund të përfitojnë nga projektet e ndërtimit nga donatorë të ndryshëm. Në gusht 2020, u miratua po ashtu Rregullorja (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave për Ndarjen në Përdorim dhe Shkëmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale. Megjithatë, si ligji, ashtu edhe rregullorja nuk përfshijnë strehimin social si mundësi ose interes të përgjithshëm për ndarjen e tokës. Opsioni i vetëm i mbetur për të kthyerit që të përfitojnë nga ndarja e tokës përcaktohet nga neni 21 i ligjit në fjalë për raste të veçanta, kur kërkesa për alokim për përdorim bëhet nga institucionet qendrore, sipas interesit të përgjithshëm publik që është në përputhje të plotë me Planin e Zhvillimit Lokal. Alokimi për përdorimin e pasurisë së paluajtshme të komunës për raste të veçanta jepet pa zbatuar procedurat e konkurrencës.⁸⁰

⁷⁸ Shih *supra* note 70, f. 25. <https://www.osce.org/files/f/documents/8/0/454182.pdf>

⁷⁹ Shih rastin KI187/13 të Gjykatës Kushtetuese, Aktgjykim i 16 prillit 2014, Shqyrtimi kushtetues i moszbatimit të Vendimit GSK-AKP-001/12, të datës 8 maj 2012, të Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme dhe të Vendimit i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/ 114/2011, të datës 22 qershor 2011. I qasshëm në https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjkk_ki_187_13_shq.pdf

⁸⁰ Shih nenin 24 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave për Ndarjen në Përdorim dhe Shkëmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale, e qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=30537>

Në vitin 2021, institucionet morën disa masa pozitive në drejtim të mbrojtjes së të drejtave pronësore të komuniteteve në situata të cenueshme, PZHBV-ve dhe grave, me ç' rast AKKVP ka kryer 29 dëbime dhe një rrënim të një strukture të paligjshme të ndërtuar në pronën e një personi të zhvendosur, duke siguruar një kthim efektiv të të drejtave pronësore.⁸¹ Po ashtu, transaksionet mashtruese të pronës dhe transferimet e paligjshme të pronësisë së pronave që u përkasin kryesisht personave të zhvendosur mbesin ende shqetësim. Po ashtu, është shënuar njëfarë progresi në zbatimin e Udhëzimit Administrativ (QRK) - Nr.01/2020 për përcaktimin e procedurave për shkatërrimin e strukturave të paligjshme, i cili u miratua në prill të vitit 2020, megjithëse mungesa e fondeve e pengon AKKVP-në që të kryejë prishjet me shpejtësi.⁸² Deri në maj të vitit 2022, AKKVP ka pasur në pritje 64 kërkesa për dëbim, ndërsa 11 raste presin ndërmarrjen e veprimeve për dëbim.⁸³

Në përputhje me Raportin për të Drejtat e Njeriut të SHBA-së për vitin 2021, për personat e zhvendosur dhe të kthyerit romë, ashkali dhe egjiptianë një nga sfidat kryesore është rezistenca e disa komunave për ndarjen e tokës dhe njohjen e të drejtave të qiradhënies ose posedimit bazuar në vendbanimet joformale të zëna para zhvendosjes për anëtarë të këtyre komuniteteve. Disa komuna dështuan të ndajnë tokë për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që kishin marrë të drejta pronësore brenda komunave, për faktin se ata kishin jetuar diku tjetër para zhvendosjes së tyre.⁸⁴ Procesi i regjistrimit në librat kadastral komunal të të drejtave të shfrytëzimit të pronës tek përfituesit e programeve të banimit nga donatorë të ndryshëm në toka komunale të ndara për 49-99 vjet në disa komuna vazhdon të mbetet i pazgjidhur për shkak të pengesave të vazhdueshme ligjore.

Qeveria e Kosovës, sidomos MKK dhe AKKVP, duhet të intensifikojë përpjekjet në mënyrë që të ketë kthim efektiv të pronave të pronarët legjitim. Kthimi i pronave nga uzurpimi i paligjshëm do të ndikojë në rritjen e sigurisë juridike të PZH dhe rrjedhimisht në kthimin e tyre. Në këtë drejtim, duhet të hartohet një plan veprimi konkret që do të përmbajë të gjitha masat për dëbimin e uzurpatorëve nga pronat e uzurpuara dhe rrënimin e strukturave të paligjshme të ndërtuara ndër vite në këto prona në mënyrë që të mundësohet kthimi i PZH në pronat e tyre.

IV.3.6. Përdorimi i gjuhëve

Përmirësimi i përkthimeve si dhe qasja në korrikulat në gjuhët e komuniteteve duhet të merret me prioritet të lartë. Sipas nenit 5 të Kushtetutës, gjuhë zyrtare në Kosovë janë gjuha shqipe dhe gjuha serbe, ndërsa boshnjake, gjuha turke dhe ajo rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komune ose do të jenë në përdorim zyrtar në cilindo nivel në pajtim me ligj. Siç është cekur më lart, Kuvendi ka miratuar edhe Ligjin Nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve me qëllim të ruajtjes së identitetit gjuhësor të komuniteteve jo-shumicë në Kosovë. Sipas nenit 2 të këtij ligji, gjuha shqipe

⁸¹ Shih Raporti i Vendit për Kosovën për vitin 2022, i qasshëm në:

⁸² Shih *supra* note 53, f. 33.

⁸³ Inputi i AKKVP përmes komenteve në formë elektronike, 12 maj 2022.

⁸⁴ Departamenti i Shtetit të Bashkuara të Amerikës (SHBA), Raporti për të Drejtat e Njeriut të SHBA-së për Kosovën, i vitit 2021, f. 14, i qasshëm në: https://xk.usembassy.gov/wp-content/uploads/sites/133/HRRreportKosovo2021_Alb.pdf

dhe gjuha serbe dhe alfabetet e tyre janë gjuhë zyrtare në Kosovë dhe kanë status të barabartë në institucionet e Kosovës.

Zyra e Komisionerit të Gjuhëve, është themeluar në vitin 2012 në kuadër të Zyrës së Kryeministrit dhe ka mandat mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave gjuhësore të komuniteteve. Në raportin e tij të fundit vjetor për pajtueshmërinë gjuhësore në komuna, të botuar më 2019, kjo zyrë vuri në dukje progres shumë të kufizuar ose aspak progres në lidhje me pajtueshmërinë gjuhësore të komunave në krahasim me vitet e kaluara. Kapacitetet e përkthimit/interpretimit në komuna janë ende të dobëta. Sfidat që kanë të bëjnë me mungesën e burimeve njerëzore, pajisjeve dhe financimit vazhdojnë.⁸⁵

Zyra e Komisionerit të Gjuhëve në funksion të adresimit të problemit të pajtueshmërisë gjuhësore si në nivelin qendror edhe atë, lokal ka iniciuar hartimin e një dokumenti analizues të politikave të ndërmarrë në këtë fushë. Si rezultat, në maj të vitit 2019, Qeveria miratoi Koncept Dokumentin për reformën e procedurave të përkthimit në kuadër të Qeverisë së Kosovës - drejt një legjisllacioni të harmonizuar shumëgjuhësh, i cili dokument hap rrugën për krijimin e një njësie për përkthim, kontroll gjuhësor dhe harmonizim në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, respektivisht, Zyrës së Komisionerit të Gjuhëve. Megjithatë, kjo njësi ende nuk është krijuar dhe as mandati i saj nuk është përfshirë në kuadër të zyrës në fjalë.

Në vitin 2018, raporti i OSBE-së “Legjisllacioni dygjuhësor në Kosovë”, konstatoi se nuk ka lekturim sistematik të projektligjeve apo angazhim të rregullt të juristëve në procesin e finalizimit të versioneve në dy gjuhët zyrtare. Përkthimet e dobëta të projektligjeve ekzistojnë kryesisht për shkak të mungesës së kapaciteteve, resurseve dhe trajnimit të përkthyesve ekzistues, si dhe shpërndarjes joefikase të këtyre përkthyesve në qeveri.⁸⁶

Në dhjetor të vitit 2021, Qeveria ka miratuar Projektligjin për Aktet Juridike, i cili parasheh institutin e korigjimit të versioneve të përkthyer me gabime të projektligjeve edhe pas miratimit të tyre nga Kuvendi, pa nevojën e procedimit të ndryshimit dhe plotësimit të ligjit në fjalë, respektivisht, korigjimi i tyre bëhet, ndër të tjera, në rastin e mospërputhjes ndërmjet gjuhëve zyrtare në aktin juridik. Po ashtu, fushëveprimi i këtij ligji përfshin edhe korigjimin për aktet e tjera juridike, siç janë aktet nënligjore.⁸⁷ Miratimi i projektligjit në fjalë nga Qeveria, ka hapur rrugën e diskutimit dhe miratimit nga Kuvendi. Korigjimet gjuhësore dhe ato teknike janë të domosdoshme ashtu që të përmirësohet qasja e komuniteteve jo-shumicë, sidomos, për komunitetin serb dhe komunitetet tjera serbisht folëse, për të cilin të gjitha aktet juridike duhet të jenë të qasshme në gjuhën serbe.

Po ashtu, sistemi i drejtësisë vazhdon të përballet me vështirësi në zbatimin e plotë të Ligjit për përdorimin e gjuhëve. Monitorimi i gjykatës nga OSBE-ja ka vërejtur një mungesë përkthimi, ose përkthim nën standard gjatë disa rasteve gjyqësore, në kundërshtim me të drejtën vendore dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Në shumë raste, vëzhguesit e gjykatave raportuan

⁸⁵ Shih *supra* note 27, f. 22. [493678.pdf \(osce.org\)](https://www.osce.org/files/f/documents/d/c/396836.pdf)

⁸⁶ Shih Raportin e OSBE-së, *Legjisllacioni dygjuhësor në Kosovë*, shtator 2018, i qasshëm në: <https://www.osce.org/files/f/documents/d/c/396836.pdf>

⁸⁷ Shih versionin e miratuar nga Qeveria në dhjetor 2021 të Projektligjit për Aktet Juridike në: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2021/12/Projektligji-per-aktet-juridike.pdf>

se në rastet me gjyqtar shqiptar dhe palë serbe, procesverbali përgatitej në gjuhën shqipe, dhe anasjelltas. Në situata të tilla, palët nënshkruajnë procesverbalet në një gjuhë që ata nuk mund ta kuptojnë. Mungesa e përkthyesve të kualifikuar çon në ngecje dhe vonesa pasi dosjet e lëndëve nuk mund të përkthehen brenda një kohe të arsyeshme. Kjo pengon efikasitetin e sistemit të drejtësisë dhe pengon gëzimin e plotë të të drejtave të palëve në proces. Për më tepër, përkthimi i legjislacionit në të dy gjuhët zyrtare mbetet sfidë, duke ndikuar edhe në qasjen në drejtësi edhe në funksionalitetin e plotë të gjyqësorit të integruar.⁸⁸

Sa i përket arsimit parauniversitar në gjuhët e komuniteteve, MASHTI ka zhvilluar kurrikulën për arsimin parauniversitar në gjuhën turke dhe boshnjake. Arsimi parauniversitar në gjuhën boshnjake është i siguar në shtatë (7) nga nëntë (9) komunat, ku ka popullsi boshnjake të Kosovës në numër të konsiderueshëm. Ndërsa, arsimi parauniversitar në gjuhën turke është i siguar në pesë (5) nga gjashtë (6) komunat, ku ka popullsi turke të Kosovës në numër të konsiderueshëm. MASHTI gjithashtu ka zhvilluar një modul në gjuhën rome me elementet e historisë dhe kulturës për nivelin fillor e që u shpaloj për herë të parë në Prizren në vitin 2011, pas miratimit të Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve Rome, Ashkali dhe Egjiptiane 2009–2015, si dhe ka hartuar librat shkollorë në gjuhën rome për klasën e dytë, tretë dhe katërt të nivelit fillor të arsimit dhe këta libra shkollorë u jepën nxënësve falas.⁸⁹

IV.3.7. Shëndetësia

Përmirësimi i qasjes në shërbimet shëndetësore për të gjitha komunitetet. Sipas legjislacionit vendor dhe konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, e drejta për shëndet nuk kufizohet vetëm në të drejtën e njeriut për kujdes shëndetësor, por përfshinë edhe të gjithë faktorët socio-ekonomikë të nevojshëm për një jetë të shëndetshme. Këta faktorë përfshijnë banimin, qasjen në ushqim, ujë të pijshëm dhe kushte higjieniko-sanitare adekuate; shëndetin dhe sigurinë në punë; dhe, jetesën në një mjedis të pandotur. Prandaj, për të përmirësuar shëndetin e grupeve të marginalizuara, duhet të bëhen përpjekje për të përmirësuar edhe këta përcaktues socio-ekonomikë, që është një nga detyrat e strategjisë.

Sipas informatave nga UNHCR-ja, familjet e kthyer të romëve, egjiptianëve, ashkalive dhe shqiptarëve kryesisht përdorin shërbimet shëndetësore të Kosovës. Të kthyerit shqiptarë nga veriu i Mitrovicës vazhdojnë të përdorin shërbimet shëndetësore në vendin e tyre të zhvendosjes. Nga ana tjetër, familjet serbe të kthyer përdorin shërbime shëndetësore që janë nën administrimin e Serbisë, për shkak të sigurimit shëndetësor dhe ilaçeve falas. Ka raste kur të kthyerit serbë përkohësisht nuk janë në vendin e tyre të kthimit për shkak të ndonjë ekzaminimi mjekësor në Serbi.

Për shkak të situatës së vështirë ekonomike, një numër i familjeve të kthyer rome, ashkali dhe egjiptiane përballen me vështirësi për mbulimin e kostos për ilaçe, pasi ato familje varen nga ndihma sociale që pranojnë në Kosovë. Krahasuar me familjet jo rome në afërsi të tyre, familjet rome rreth 10 përqind më pak përdorin shërbimet shëndetësore parandaluese. Po ashtu, për

⁸⁸ Shih *supra* note 27, f. 28. (OSBE 2021)

⁸⁹ Raporti i OSBE-së, *Qasja e Komuniteteve në Arsimin Parauniversitar në Kosovë*, dhjetor 2018, f. 13-16, e qasshme në: https://www.osce.org/files/Community%20Education%20report_Albanian_layout.pdf.

komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane, kushtet e jetesës në disa vendbanime të tyre kanë qenë shumë shqetësuese, sidomos kampet e kontaminuara nga plumbi, ngase kanë përbërë rrezik serioz për shëndetin e banorëve, si dhe niveli i vaksinimit, sidomos i fëmijëve të tyre, mbetet shqetësues.⁹⁰ Fatmirësisht, këto kampe janë mbyllur. Në këtë kontekst, gjithsej 73 përqind e fëmijëve të moshës 24–35 muaj në Kosovë kanë marrë të gjitha vaksinat në orarin e imunizimit ndërsa vetëm 38 përqind e fëmijëve që jetojnë në komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane janë vaksinuar plotësisht.⁹¹

Për shkak të shpërthimit të rasteve me COVID 19, shërbimet shëndetësore të natyrës jo emergjente në institucionet shëndetësore sekondare dhe terciare janë pezulluar përkohësisht gjatë vitit 2020 dhe 2021, pasi qëllimi i sistemit shëndetësor ishte i fokusuar në parandalimin dhe trajtimin e Pacientët e infektuar me COVID 19. Po ashtu, sikur në vende të tjera të botës, edhe autoritetet e Kosovës kanë marrë një numër masash dhe vendimesh për të luftuar shpërthimin e pakontrolluar të COVID-19, i cili në drejtim të qasjes në parandalimin dhe trajtimin kishte ndikim në të drejtën për shëndetin, qasjen në masat sanitare, qasjen në informacion dhe mosdiskriminim. Masat kufizuese, si dhe ndikimi i pandemisë në situatën socio-ekonomike dhe pasiguria e përgjithshme për të ardhmen çuan në rritje të çrregullimeve në shëndetin mendor (ankth/çrregullime të gjumit) dhe dhunë në familje. Gjithsej 23 të kthyer kanë marrë trajtim psikosocial për shkak të problemeve të lidhura me COVID 19.⁹² Komunitetet e prekura rome, ashkali dhe egjiptiane të kthyer ishin veçanërisht të ekspozuar ndaj një rreziku të lartë shëndetësor për shkak të kushteve të këqija të strehimit, mungesës së infrastrukturës bazë dhe të ardhurave të rregullta. Shumë prej tyre kishin mungesë të burimeve të informacionit dhe qasje të kufizuar në ilaçe dhe mjete mbrojtëse. Ata shpesh ishin të kufizuar në kushte të mbipopulluara me shumë anëtarë të familjes që jetonin në një hapësirë të vogël, ku ishte e pamundur të zbatoheshin në mënyrë efektive masat e izolimit. Shumë prej grave shtatzëna ishin në rrezik të lartë për shkak të mungesës së artikujve higjienikë, mungesës së ushqimit të duhur, jetesës në vendbanime jo-higjienike dhe kontroleve jo të rregullta mjekësore. Të kthyerit nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, të cilët ishin të angazhuar në mbledhjen e plehrave të ripërdorura dhe lypjen në rrugë ishin të ekspozuar ndaj rrezikut të lartë të përmbajtjes së COVID 19, për shkak të mungesës së ingranazheve mbrojtëse. Po ashtu, në kontekst të vaksinimit rutinor, janë identifikuar 43 fëmijë që nuk janë imunizuar, kryesisht nga komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane.⁹³ Kishte shqetësime të ngritura në lidhje me mungesën e ilaçeve nga të kthyerit, për shkak të gjendjes së tyre të vështirë ekonomike. Nga ana tjetër, serbët e kthyer gjithashtu nuk kanë pranuar ilaçe që zakonisht i merrnin falas përmes sigurimit shëndetësor serb. Për shkak të mungesës së provave masive të qytetarëve, ilaqe u jepeshin vetëm të atyre me simptoma të qarta dhe personave në kontakt me raste pozitive të COVID 19.

Sfida e mbetur ekziston me imunizimin e të kthyerve dhe PZHBV-ve me vaksinën COVID 19. Ministria e Shëndetësisë posedon të dhëna të imunizimeve sipas gjinisë, profesioneve,

⁹⁰ Shih *supra* note 40, f. 11. (admovere)

⁹¹ Shih Anketën e UNICEF-it, MICS (2019-2020), Anketa e grupeve me tregues të shumëfishtë për komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane në Kosovë, nëntor 2020, e qasshme në: <https://www.unicef.org/kosovoprogramme/media/1871/file/Kosovo%20MICS%202020.pdf> .

⁹² Shih *supra* note 64, f. 7. Organizata “Advancing together”, Sfidat e Qëndrueshmërisë dhe Riintegritit të të Kthyerve/PZhBV-ve, f. 7, nëntor 2021, i qasshëm në: <https://advancing-together.org/reports/ENG%20-%20Sustainability%20and%20Reintegration%20Challenges%20Report%20November%202021.pdf>

⁹³ Po aty. Organizata “Advancing together

vendbanimeve dhe moshës,⁹⁴ por jo edhe sipas etnisë. Megjithatë, në vitin 2021, Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Pushtetit Lokal, dërguan ekipe mobile të vaksinimit në vendbanimet kryesore të komuniteteve në komunat e Gjakovës, Prizrenit, Fushë Kosovës, Pejës, Mitrovicës Jugore dhe Prizrenit, ku u imunizuan gjithsej 1700 individë. Vlen të theksohet se të kthyerit nga Serbobrani të Istogut, kanë refuzuar dy herë ekipet mobile shëndetësore për vaksinim kundër COVID-19, për shkak të frikës nga efektet anësore dhe dezinformatave në rrjetet sociale, ndërsa të kthyerit serb kanë kryer vaksinimin në sistemin serb, i cili ndër të tjera u ka siguruar edhe transportin.⁹⁵

Në përgjithësi, gratë dhe burrat përballen me pengesa të ngjashme për qasjen në kujdesin shëndetësor. Megjithatë, gratë përballen me më shumë pengesa socio-kulturore. Gratë në zonat rurale përballen me pengesa financiare, kulturore dhe në marrëdhëniet pacient-ofrues shërbimi në aksesin në kujdesin shëndetësor, më shumë se burrat apo gratë në zonat urbane. Gratë boshnjake dhe turke të Kosovës kanë më shumë tendencë të përballen me barriera sesa burrat e së njëjtës etni, ndërsa gratë dhe burrat romë, ashkali, egjiptianë dhe goranë të Kosovës përballen me më shumë barriera gjeografike, financiare dhe kulturore në qasjen në kujdesin shëndetësor.⁹⁶ Ekzistojnë dallime në përdorimin e shërbimeve shëndetësore bazuar në përkatësinë etnike dhe gjinore.⁹⁷ Serbët e Kosovës dhe goranët e Kosovës priren të përdorin shumicën e shërbimeve, ndërsa shqiptarët e Kosovës dhe boshnjakët e Kosovës më së paku. Burrat goranë të Kosovës përdorin më shumë shërbime sesa gratë gorane të Kosovës. Si gratë shqiptare, ashtu edhe ato turke të Kosovës përdorin më shumë shërbime sesa burrat e së njëjtës etni. Nuk ekzistojnë dallime domethënëse ndërmjet grave dhe burrave romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës në këtë drejtim. Disa nëna rome, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës lindin në shtëpi, shpesh në kushte jo sanitare. Si rezultat, shumë fëmijë nuk janë të regjistruar zyrtarisht. Kjo ndikon në qasjen në kujdesin shëndetësor më vonë në jetë, pasi personat e paregjistruar nuk mund të përfitojnë mirëqenie sociale ose qasje në shërbimet e kujdesit shëndetësor publik.

Edhe pse aktualisht, ekziston një qasje falas në sistemin shtetëror shëndetësor, i njëjti nuk është efektiv për shkak të mbingarkesës. Aktualisht, të gjithë të kthyerit serbë kanë sigurim shëndetësor nga Serbia, ndërsa të kthyerit e tjerë nga etni të ndryshme nuk kanë sigurim shëndetësor. Kjo për shkak se Ligji Nr. 04/L-249 për Sigurimet Shëndetësore ende nuk po zbatohet, tetë vite pas miratimit të tij.⁹⁸ Duhet të ndërmerren politika të mirëfillta shëndetësore që mundësojnë qasje të barabartë dhe efektive për të gjitha komunitetet, përfshirë, një sistem efektiv të sigurimeve shëndetësore. Kjo do të nxisë edhe kthimin e PZH dhe do t'i përmirësonte shkallën e përdorimit të shërbimeve shëndetësore të Kosovës nga të kthyerit dhe komunitetet jo-shumicë në Kosovë, të cilët përdorin sistemin shëndetësor të ofruar nga Serbia. Komunat po ashtu duhet të përfshihen në zgjidhjen e këtij problemi duke përmirësuar shërbimet në institucionet parësore shëndetësore. Në fund, siç theksohet në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2030, investimet në kujdesin shëndetësor duhet të reflektojnë një rritje të jetëgjatësisë së përgjithshme, por duhet të adresojnë

⁹⁴ Shih të dhënat statistikore të Ministrisë së Shëndetësisë sipas kategorive të lartcekura, të qasshme në <https://msh.rks-gov.net/sq/statistikat-covid-19/>

⁹⁵ Shih *supra note* 67. Organizata “Advancing together”

⁹⁶ Farnsworth, Nicole, Dr. Katja Goebbels dhe Rina Ajeti. *Qasja në kujdesin shëndetësor në Kosovë*. RrGK: 2016, e qasshme në: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2021/05/qasja.pdf>

⁹⁷ Po aty.

⁹⁸ Shih *supra note* 67, f. 8. Organizata “Advancing together”

veçanërisht shëndetin e fëmijëve, duke reduktuar shkallën e vdekshmërisë së fëmijëve, veçanërisht ato të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane.

IV.3.8 Kultura

Nxitja e aktiviteteve kulturore dhe organizimit të manifestimeve që promovojnë përfaqësimin multi-etnik dhe respektimin e trashëgimisë kulturore është një mjet efektiv për integrimin e komuniteteve. Kultura luan një rol jashtëzakonisht të madh në krijimin dhe fuqizimin e identitetit për një shoqëri në zhvillim demokratik. Duke pasur parasysh pasurinë kulturore me kultura të ndryshme që ka shoqëria kosovare, MKK-ja ka pasur një kujdes të veçantë për kujdesin ruajtjen dhe zhvillimin e kulturës. Gjithashtu, janë krijuar kushte në qasje në informim të komuniteteve dhe që zëri i tyre të dëgjohej gjatë vendimmarrjes, dhe kështu të ndikohet në ekzistencën e tyre.

Rritja e pjesëmarrjes së komuniteteve në procesin e vendim – marrjes për bërjen e politikave dhe zbatimin në fushën e kulturës, do të lehtësonte tej mase përkrahjen për komunitetet. Diversiteti, dialogu kulturor, komunitetet duhet të mbështeten me projekte të profileve të ndryshme, dhe aktivitete kulturore, artistike e sportive.

Disa nga rekomandimet që do të ndikojnë në përmirësimin e gjendjes në fushën e kulturës janë: pjesëmarrja në jetën kulturore dhe publike, organizimi i manifestimeve kulturore dhe të tjera, përfaqësimi multi-etnik nëpër festivale si dhe ngritja e vetëdijës për respektimin e trashëgimisë kulturore dhe historike.

IV.3.9. Dhuna në baza gjinore, dhuna në familje dhe martesat e hershme

Dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje janë të pranishme dhe përbëjnë një shqetësim pansocial në Kosovë. Rrënjët e këtyre formave të dhunës ushqehen nga pabarazitë gjinore dhe strukturore, të reflektuara në: pjesëmarrjen politike dhe ekonomike, qasja në pronë, të ardhura dhe shërbime, si dhe në standardet dhe cilësinë e jetës. Gratë nuk marrin pjesë në baza të barabarta me burrat në vendimmarrje, punësim, ekonomi dhe shumë fusha të tjera. Ato nuk kanë të njëjtën qasje si burrat në tregun e punës, shërbimet mbështetëse, kreditë, etj.⁹⁹

Për më tepër, Anketa e Treguesve të Shumëfishtë për Kosovën (MICS) për komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane të Kosovës në Kosovë, e kryer në periudhën 2019-2020 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) si pjesë e programit global MICS,¹⁰⁰ kanë identifikuar, ndër të tjera se:

- ✓ Në grupmoshën 15-49 vjeç, 25 për qind e vajzave / grave të reja / grave dhe 57 për qind e vajzave / grave të reja / grave të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane të Kosovës, si dhe 12 për qind e djemve / të rinjve/ burrave dhe 26 për qind e djemve/ të rinjve/ burrave nga komunitetet rome, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës në Kosovë justifikojnë dhunën

⁹⁹ Shih f. 15 të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen kundër Dhunës në Familje dhe Dhunës ndaj Grave 2022-2026, e qasshme në: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/03/ALB-Strategjia-Kombëtare-për-Mbrojtje-nga-Dhuna-në-Familje-dhe-Dhuna-ndaj-Grave-2022---2026.pdf>

¹⁰⁰ Mbështetur nga UNICEF, i qasshëm në: <https://mics.unicef.org/surveys>

fizike ndaj grave të tyre për një nga arsyet e mëposhtme: largimin nga shtëpia pa u thënë; neglizhimi i fëmijëve; refuzimi për të bërë seks me të; djegia e ushqimit;

- ✓ Një në tre gra të reja të moshës 20-24 që jeton në komunitetet rome, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës janë martuar ose kanë bashkëjetuar para moshës 18 vjeçare;
- ✓ Vetëm një në katër adoleshentë të moshës 10–14 vjeç në Kosovë disiplinohet me metoda jo të dhunshme;
- ✓ Rreth një në dhjetë vajza / gra të reja të moshës 15–19 vjeç në popullatën e përgjithshme dhe ato që jetojnë në komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane të Kosovës raportuan se kishin përjetuar diskriminim dhe ngacmim në bazë gjinore.

Anketa e OSBE-së për Mirëqenien dhe Sigurinë e Grave në Kosovë, e publikuar në vitin 2019,¹⁰¹ paraqet gjetjet nga studimi cilësor dhe sasior i OSBE-së në Kosovë për dhunën ndaj grave. Studimi paraqet ndër të tjera një mostër përfaqësuese prej 1,990 grave të moshës 18-74 që jetojnë në Kosovë, duke përfshirë 1,690 gra që jetojnë në zonat e banuara kryesisht nga shqiptarët e Kosovës dhe 300 gra që jetojnë në zonat e banuara kryesisht nga serbët e Kosovës. Në anketë u përfshinë edhe komunitete të tjera që jetojnë në këto zona.¹⁰² Gjetjet kryesore të anketës tregojnë se gratë serbe të Kosovës kanë më shumë gjasa të thonë se kanë përjetuar dhunë fizike ose seksuale sesa shqiptarët e Kosovës (34 për qind kundrejt 13 për qind). Më shumë shqiptarë të Kosovës sesa serbë të Kosovës pajtohen se dhuna kundër grave shpesh provokohet nga viktimat (36 për qind kundrejt 23 për qind) dhe se dhuna në familje është një çështje private që duhet trajtuar brenda familjes (49 për qind kundrejt 38 për qind). U vu re se gratë serbe të Kosovës ishin më të gatshme për të shpalosur përvojat e tyre gjatë intervistës së anketës. Për më tepër, intervistat me ekspertët thanë se gratë nga komunitetet e ndryshme joshumicë, si serbët e Kosovës, goranët, turqit e Kosovës, romët, ashkalitë e Kosovës dhe gratë egjiptiane të Kosovës kanë qasje të dobëta në shërbime dhe kanë më shumë gjasa se gratë e tjera t'i nënshtrohen ndaj diskriminimit nga ofruesit e shërbimeve. Po ashtu, sipas të dhënave nga UNHCR, gjatë periudhës së karantinës në vitin 2020, janë identifikuar dhe raportuar 54 të mbijetuar të dhunës seksuale dhe të dhunës me bazë gjinore (SGBV), kryesisht që i përkasin komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane. 75 për qind e incidenteve kanë të bëjnë me mohimin e burimeve, mundësive dhe shërbimeve dhe 25 për qind kanë të bëjnë me sulme seksuale dhe fizike, martesë të detyruar (të hershme) dhe abuzim psikologjik/emocional.¹⁰³

Prevalenca e martesave të hershme ka vazhduar në komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës, por edhe në zonat rurale në përgjithësi. Gjithashtu, një raport i Fondit të Kombeve të

¹⁰¹ OSBE, *Anketa për Mirëqenien dhe Sigurinë e Grave në Kosovë*, 2019, raporti i qaashëm në: <https://www.osce.org/files/f/documents/d/c/439781.pdf>

¹⁰² Gjithsej 179 gra u identifikuan që u përkasin komuniteteve të tjera.

¹⁰³ Zyra e Shefit të Misionit në Prishtinë, UNHCR, COVID-19 - Vlerësime gjithëpërfshirëse të nevojave me personat që UNHCR kujdeset për mbrojtjen e më të cenuarve, 20 maj 2020, raporti i qaashëm në: <https://kosovoteam.un.org/sites/default/files/2020-11/UNHCR%20-%20Comprehensive-Needs-Assessments-COVID-19.pdf>

Bashkuara për Popullsinë,¹⁰⁴ ka treguar se rastet e martesave të hershme në Kosovë, duke përfshirë edhe fëmijët në përgjithësi, mbeten një fenomen i rrallë. Prevalenca e rasteve të martesave të hershme ka vazhduar në komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës, por edhe në zonat rurale si dhe në diasporë. Megjithatë, nuk ka statistika të mbledhura dhe të raportuara me saktësi, pasi shumë martesë nuk regjistrohen menjëherë dhe martesë nën moshën 16 vjeçare në Kosovë konsiderohet vepër penale (Raporti i Këshillit të Evropës 2017: 42017: 4).

Në bashkëpunim me institucionet relevante, MKK duhet të angazhohet në organizimin e fushatave vetëdijësuese në parandalimin e dhunës në baza gjinore, dhunës në familje dhe martesave të hershme të komuniteteve jo-shumicë, me fokus në komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane, si dhe në integrimin në shoqëri të viktimave nga këto dukuri.

V. OBJEKTIVAT STRATEGJIKË DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË

Objektivat dhe masat strategjike të paraqitura në këtë dokument janë identifikuar duke u bazuar në përvojat dhe analizën e strategjisë së periudhës paraprake (2014-2018), të dhënat e paraqitura në analizën e gjendjes aktuale të komuniteteve në këtë dokument strategjik, informatave nga terreni dhe rekomandimeve të ofruara nga grupi punues. Përveç objektivave të identifikuar, janë zhvilluar edhe aktivitete konkrete të paraqitura në Planin e Veprimit.

Vizioni i Qeverisë së Kosovës është që *Kosova të jetë një shoqëri që siguron të drejtat e të gjitha komuniteteve dhe t'i përmbushë standardet më të larta të respektimit të të drejtave të njeriut, siç janë përcaktuar në konventa ndërkombëtare relevante, në Kushtetutën e Kosovës dhe në legjislacionin në fuqi.*

Për ta arritur këtë vizion, Qeveria merr për obligim të promovojë dhe lehtësojë kthimin e sigurte dhe me dinjitet të refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit, t'u ndihmojë atyre kthimin e pronave dhe posedimeve të tyre, si dhe të sigurojë realizimin efektiv të të drejtave të të gjitha komuniteteve në veçanti qasjen në arsim, punësim, shërbime shëndetësore dhe banim, mundësi të barabarta në përdorimin e gjuhëve me qëllim të përfshirjes së tyre të plotë në të gjitha aspektet e jetës shoqërore në Kosovë. Ky është misioni i kësaj strategjie.

Kjo strategji për qëllim e ka kthimin, ri integrimin, integrimin dhe stabilizimin e komuniteteve në Kosovë. Me zbatimin e saj, synohet që të përmirësohet cilësia e jetesës në sferën e arsimit, punësimit dhe mirëqenies sociale, strehimit, çështjeve pronësore, përdorimit të gjuhëve, shëndetësisë, si dhe kulturën për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë, si dhe për PZH që duan të kthehen në vendbanimet e tyre të mëhershme dhe PZHBV te cilët dëshirojnë te integrohen në vendin e zhvendosjes.

Këto objektiva strategjike janë në pajtim me parimet e Këshillit të Evropës.

¹⁰⁴ UNFPA, *Martesa e Fëmijëve në Kosovë*, raporti i qasshëm në: <https://eeca.unfpa.org/sites/default/files/pub-pdf/unfpa%20kosovo%20overview.pdf>

Kjo strategji është e bazuar në tri parime kryesore, të harmonizuara me standardet ndërkombëtare dhe evropiane për pakicat kombëtare:

- Parimi i të drejtave të barabarta dhe mundësive të barabarta - ky parim njih nevojën që pjesëtarët e të gjitha komuniteteve të kenë mundësi të barabarta në të gjitha fushat e shoqërisë.
- Parimi i mos diskriminimit - bazuar në këtë parim të gjitha masat e ndërmarra sigurojnë që, në mënyrë të konsiderueshme, të zvogëlon shkallën e diskriminimit ndaj komuniteteve jo-shumicë në Kosovë në të gjitha aspektet e jetës shoqërore.
- Parimi i promovimit të të drejtave të komuniteteve jo-shumicë – nënkupton kushtet e nevojshme për personat që i përkasin pakicave kombëtare që të ruajnë dhe zhvillojnë kulturën e tyre dhe të ruajnë elementet thelbësor të identitetit të tyre, përkatësisht fenë, gjuhën, traditat dhe trashëgiminë kulturore të tyre.

VI.1. OBJEKTIVI STRATEGJIK 1

Objektivi strategjik 1: Kthimi, ri integrimi, integrimi dhe ofrimi i mundësive për zgjidhje të qëndrueshme për personat e zhvendosur dhe të kthyerit vullnetarë jo shumicë

MKK-ja sipas mandatit të saj vepron në komunat me shumicë serbë lidhur me procesin e kthimit të personave të zhvendosur në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të aplikueshme në Kosovë, barazia etnike, fetare, gjinore, racore, liria e lëvizjes, të drejtat pronësore dhe interesi më i mirë i fëmijëve, si dhe lirinë nga diskriminimi do të zbatohen gjatë procesit të kthimit dhe ri-integrimit të personave të zhvendosur.

Kthimi i PZh mbetet sfidë, për shkak të problemeve pronësore me pronat e uzurpuara dhe mungesës së rrëtimeve të strukturave të paligjshme, të cilat janë ndërtuar ndër vite në pronat e PZh.

Andaj, integrimi dhe zgjidhja e qëndrueshme për personat e zhvendosur dhe të kthyerit është prioritet për MKK-në dhe Qeverinë. Për arritjen e këtij objekti do të vijojnë aktivitetet duke përfshirë mbështetjen e projekteve që synojnë koordinimin e institucioneve për kthimin e qëndrueshëm të PZh.

MKK është në proces të funksionalizimit të bazës së të dhënave për numrin e PZh dhe të të kthyerve në Kosovë. Bazuar në pasqyrat statistikore të nxjerra nga UNHCR (e fundit, dhjetor 2022), sipas së cilave vlerësohet se 15,683 persona janë zhvendosur brenda vendit. Ndërsa rreth 29,268 persona të zhvendosur janë kthyer dhe kanë gjetur zgjidhje të qëndrueshme.

Kjo do të realizohet përmes ndjekjes së masave strategjike të mëposhtme:

- Forcimi i koordinimit dhe shkëmbimi i informacionit midis institucioneve në nivelin lokal dhe qendror në procesin e mbështetjes për kthim dhe ri-integrim;

- Avancimi i bashkëpunimit rajonal në gjetjen e zgjidhjeve të përhershme për personat e zhvendosur;
- Ofrimi i ndihmës personave të interesuar për kthim në përputhje me Rregulloren (QRK) Nr. 01/2018;
- Ofrimi i ndihmës për PZH që jetojnë në qendrat kolektive dhe në banimin privat;
- Fuqizimi i mekanizmave ekzistues të vendosur midis ministrive relevante në kuptim të ofrimit të mundësive për alokimin e tokës;
- Sistemi i menaxhimit të të dhënave do të përdoret për të marrë informacion për të gjitha familjet e PZHBV-ve në nivel qendror dhe lokal, si dhe statistika të sakta.
- Institucionet lokale;
- Buxhetimi i fondeve në nivel lokal dhe qendror për ndërtimin e banesave për të kthyerit në zonat urbane;
- o Forcimi i koordinimit ndërmjet institucioneve në nivel lokal dhe qendror në procesin e mbështetjes së integritit të të kthyerve në shoqërinë kosovare;
- o Sigurimi i mbështetjes për të kthyerit për stabilitet socio-ekonomik dhe qëndrueshmëri afatgjatë të kthimit;
- o Përfshirja e organizatave ndërkombëtare për të mbështetur të gjithë procesin.

Për arritjen/përmbushjen e objektivës strategjike janë paraparë këto objektiva specifike:

Objektivi specifik 1.1. Angazhim i intensifikuar i institucioneve relevante në lidhje me ofrimin e shërbimeve për kthimin dhe ri integrimin e personave të zhvendosur;

Objektivi specifik 1.2. Avancimi i kornizës ligjore në fushën e integritit të të kthyerve dhe komuniteteve në Kosovë.

Objektivi specifik 1.3. Forcimi i koordinimit dhe shkëmbimi i informacionit në mes të qeverisjes lokale dhe qendrore sa i përket zgjidhjeve së qëndrueshme.

Objektivi specifik 1.4 Mbyllja e qendrave kolektive;

Objektivi specifik 1.5. Kthimi vullnetarë dhe urban

VI.2. OBJEKTIVI STRATEGJIK 2

Objektivi strategjik 2: Stabilizimi i komuniteteve dhe përmirësimi i mirëqenies së komuniteteve duke ofruar mundësi të barabarta të arsimit, të punësimit, shërbimeve sociale, të mbrojtjes, si dhe kulturës.

MKK-ja sipas mandatit të saj vepron në komunat me shumicë serbë lidhur me stabilizimin e komuniteteve dhe përmirësimin e mirëqenies të komuniteteve duke ofruar mundësi të barabarta të arsimit, të punësimit, shërbimeve sociale, të mbrojtjes, si dhe kulturës.

Stabilizimi i komuniteteve dhe integrimi i tyre duhet të merren me prioritet të lartë. Me gjithë përpjekjet e Qeverisë për integrim të të gjitha komuniteteve në Kosovë, ende ka probleme dhe sfida në këtë drejtim. Disa nga komunitetet jo shumicë nuk janë të përfshira në sistemin arsimor brenda kornizës institucionale të Kosovës. Po ashtu, shkalla e papunësisë në mesin e shumicës së pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë, veçanërisht romëve, ashkalive dhe egjiptianëve, mbetet jo proporcionalisht e lartë.

Andaj, përmirësimi i mirëqenies së të gjitha komuniteteve në Kosovë duke ofruar mundësi të barabarta të punësimit dhe arsimit është një nga prioritetet e MKK-së, në bashkëpunim të ngushtë me ministrinë përgjegjëse për punë dhe mirëqenie sociale, si dhe për arsim. Qëllimi është të mbështesë stabilizimin, ri integrimin, integrimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të komuniteteve. Për arritjen e këtij objektivi do të vijojnë aktivitetet duke përfshirë mbështetjen në edukim dhe zhvillim profesional të projekteve që synojnë krijimin e të ardhurave dhe mundësisë të punësimit, ri integrimin dhe mirëqenien e komunitetit, si dhe përmes mbështetjes së shoqërisë civile. MKK-ja do t'i kushtojë rëndësi të veçantë mbështetjes së zhvillimit ekonomik të grupeve të konsideruara si të cenueshme nga radhët e komuniteteve.

Kjo do të zbatohet nëpërmjet masave strategjike të mëposhtme:

- Komunitetet në Kosovë, të përkrahura për zhvillim ekonomik, kulturor dhe social;
- Mbështetja e projekteve të përbashkëta për zhvillimin ekonomik dhe gjenerimin e të ardhurave për komunitetet;
- Sigurimi i paketave të ndihmës sociale/ekonomike për të kthyerit, pjesëtarët e komuniteteve të kthimit dhe anëtarët e komuniteteve jo-shumicë;
- Rritja e mbështetjes për organizatat dhe grupet e cenueshme si: gratë, të rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuara;
- Rritja e mbështetjes për zhvillimin ekonomik për komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane;
- Koordinim i përmirësuar ndërmjet institucioneve përkatëse për përmirësimin e kushteve për të gjithë komunitetet në Kosovë;
- Forcimi i koordinimit ndërmjet institucioneve në nivel lokal dhe qendror në procesin e mbështetjes së komunitetit;
- Bashkëpunimi me institucionet kompetente për gjetjen e zgjidhjes për vendbanimet joformale;
- Prezantimi i udhëzimeve për promovimin e dialogut ndërmjet komuniteteve përmes arsimit në Kosovë;

- Të koordinojë mbështetjen me aktorët përkatës në lidhje me personat e zhvendosur dhe të kthyerit vullnetarë të cilët vazhdojnë të përballen me probleme me regjistrimin civil dhe lëshimin e dokumenteve personale.
- Forcimi i mbështetjes së Qendrave Mësimore me fonde dhe aktivitete për ngritjen e kapaciteteve për planifikim efektiv të buxhetit, si dhe në procesin e vlerësimit dhe raportimit vjetor;
- Koordinim i përmirësuar ndërmjet institucioneve përkatëse për përmirësimin dhe sigurimin e teksteve shkollore parauniversitare në të gjitha gjuhët e komuniteteve;
- Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet gabimeve në përkthimin e librave të arsimit
- Përfshirja e përfaqësuesve civil dhe politike nga të gjitha komunitetet (serb, turk, boshnjak, rom, ashkali, egjiptian, goran, malazet, kroat dhe komunitete të tjera) në identifikimi , adresimin dhe zgjidhjen e çështjeve që ndërlidhen me përmirësimin e mirëqenies së komuniteteve duke ofruar mundësi të barabarta të arsimit, të punësimit, shërbimeve sociale, të mbrojtjes, si dhe kulturë.
- Sigurimi i mbështetjes të komuniteteve jo shumicë sipas kotës së përfaqësimit të tyre.
- Forcimi i koordinimit ndërmjet institucioneve në nivel lokal dhe qendror për të identifikuar dhe mbështetur nxënësit jo-shumicë që përballen me sfida për të hyrë në arsimin parauniversitar (mbështetja e programeve parashkollore me bazë në komunitet dhe subvencionimi i tarifave të regjistrimit në institucionet parashkollore publike për fëmijë, transport i rregullt dhe i besueshëm për shkollën, adresimi i çështjes së braktisjes dhe forcimi i punës së Ekipeve për Parandalimi dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe mosregjistrimi (PRTAN), ofrimi i kurseve të gjuhës për fëmijët e kthyer;
- Forcimi i koordinimit ndërmjet institucioneve në nivel lokal dhe qendror për të mbështetur më tej qasjen e komuniteteve jo shumicë në arsimin e lartë;
- Rithemelimi dhe funksionalizimi i Komisionit për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës Veriore me mandat të zgjeruar në nivelet e arsimit parauniversitar, për t'u mundësuar komuniteteve jo shumicë qasje në programe arsimore dhe mundësi punësimi;
- Ndërtimi (krijimi) i Shtëpisë së Miqësisë: a) Vendosja e bashkëpunimit me institucionet vendore dhe qendrore për të mundësuar realizimin e këtij misioni dhe përcaktimin e bartësve dhe drejtuesve të këtij projekti; b) Ndërtimi ose përcaktimi i hapësirës ku do të realizohen aktivitetet; c) Përfshirja e sektorit të OJQ-ve në krijimin dhe realizimin e aktiviteteve të këtij projekti;
- Mbështetja dhe subvencionimi i bizneseve të vogla dhe dyqaneve të artizanatit;
- Sigurimi i artikujve ushqimor dhe higjienik për ofrimin e ndihmës për të pa punët nga radhët e grupeve të cënueshme të komuniteteve Rome , Ashkali dhe Egjiptianë
- Parandalimi i dhunës , diskriminimi dhe ngaçmimi në baza gjinore.

Për arritjen/përmbushjen e objektivës strategjike janë paraparë këto objektiva specifike:

Objektivi specifik 2.1. Rritja e mundësive për punësim të komuniteteve jo-shumicë me fokus të veçantë në grupet e cënueshme siç janë të kthyerit, gratë, të rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuara;

Objektivi specifik 2.2. Rritja e mundësive për arsim të përgjithshëm, arsim dhe aftësim profesional të komuniteteve jo-shumicë me fokus të veçantë në grupet e cenueshme siç janë gratë, të rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuara.

Objektivi specifik 2.3: Përkrahja e zhvillimit, kultivimit dhe ruajtjes së diversitetit kulturor, identitetit kulturor e atë kombëtar të komuniteteve jo-shumicë dhe dialogu ndërkulturor

- Mbështetje socio ekonomike për fëmijët nga grupet e cenueshme të komuniteteve Romë, Ashkali, dhe Egjiptianë

VI.3 OBJEKTIVI STRATEGJIK 3

MKK-ja sipas mandatit të saj, përveçse angazhimit të saj për përfaqësim proporcional të komuniteteve pakicë në administratën publike, vepron edhe në komunat me shumicë serbë lidhur me përfaqësimin proporcional të komuniteteve pakicë në administratën publike në ato komuna ku komuniteti serbë është shumicë.

Objektivi strategjik 3: Përfaqësimi proporcional i komuniteteve pakicë në administratën publike

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si instrument themelor juridik që rregullon organizimin shtetëror dhe me garanci të rëndësishme për komunitetet jo shumicë që e definojnë Kosovën si “shoqëri multietnike, e cila qeveriset në mënyrë demokratike me respekt të plotë të sundimit të ligjit përmes institucioneve legjislativë, ekzekutive dhe gjyqësore”. Kapitulli III i Kushtetutës përcakton në mënyrë specifike të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë. Kushtetuta promovon qartë parimin e mos diskriminimit dhe garanton se Kosova do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur personat që mund të kërcënohen me diskriminim. Në të njëjtën kohë, Kushtetuta urdhëron që Kosova duhet të marrë masa për të siguruar drejtësi të plotë dhe efektive në sfera të ndryshme të jetës – ekonomike, politike dhe sociale – për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë. Në mes të komuniteteve jo shumicë në institucionet publike dhe ndërmarrjet publike.

Neni 61 thotë se “komunitetet dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtën e përfaqësimit të drejtë në punësim në organet publike dhe ndërmarrjet publike në të gjitha nivelet [...]”. Neni 101(1) i Kushtetutës përcakton se përbërja e shërbimeve publike “duhet të pasqyrojë diversitetin e banorëve të Kosovës”. Kosova deklarativisht dhe ligjërisht është e përkushtuar për respektimin, mbrojtjen dhe promovimin e identitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar të të gjithë personave dhe komuniteteve që jetojnë në Kosovë në një mjedis të karakterizuar nga toleranca, integrimi dhe respekti reciprok përmes miratimit të garancive të nevojshme ligjore në mënyrë që të arrihet ky qëllim. Përveç të drejtave të përcaktuara me Kushtetutë, garancitë përkatëse dhe mbrojtja e komuniteteve janë të parapara, ndër të tjera, në disa rregullore të UNMIK-ut dhe në Ligjin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë.

Me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të të gjitha komuniteteve, neni 22 i Kushtetutës rendit marrëveshjet ndërkombëtare që janë drejtpërdrejt të zbatueshme dhe u jep përparësi atyre

marrëveshjeve ndaj dispozitave ligjore parësore dhe detyësore dhe akteve të tjera me interes publik në rast të konfliktit ndërmjet tyre.

ZKM, MKK-ja dhe Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim duhet kujdesen për kuotën e punësimit prej 10 % , për përfaqësim te komuniteteve në institucione sipas legjislacionit në fuqi.

Për arritjen-përmbushjen e objektivit strategjik 3 janë parashikuar synimet e mëposhtme specifike:

Objektivi specifik 3.1 *Formimi i një organi qeveritar për zhvillimin e kornizës juridiko-institucionale për integrimin e komuniteteve jo shumicë në administratën publike të Kosovës.*

Objektivi specifik 3.2 *Sigurimi i mbështetjes ligjore dhe teknike për monitorimin e zbatimit të programit.*

Objektivi specifik 3.1 Formimi i një trupi punues qeveritar për zhvillimin e kornizës juridiko-institucionale për integrimin e komuniteteve jo shumicë në administratën publike të Kosovës

Në legjislacionin e Kosovës dhe në vetë kushtetutën ka dispozita që flasin për përfaqësimin proporcional të të gjitha komuniteteve në sektorin publik, por këto dispozita janë të natyrës shumë të përgjithshme dhe deklarative. Për këtë arsye është e nevojshme të specifikohen ato dispozita në bazë të rezultateve që duhet të dalin nga arritja e qëllimit specifik të përshkruar më lartë 3.1. Nga gjendja e njohur përgjithësisht e kur është fjala për këtë çështje, vlerësimi do të tregojë se ekziston një hendek i madh ndërmjet përfaqësimit aktual të komuniteteve joshumicë në sektorin publik dhe nivelit që duhet të bazohet në numrin e banorëve në Kosovë.

Për ta arritur këtë, duhet të formohet një trup punues, detyra e të cilit do të jetë fillimisht ndërtimi i kornizës institucionale dhe ligjore dhe më pas zbatimi i masave të nevojshme për përmirësimin e përfaqësimit të komuniteteve pakicë në sektorin publik në Kosovë. Ky trup punues duhet të përbëhet nga përfaqësues të qeverisë nga niveli qendror dhe ai lokal, si dhe të përfshijë përfaqësues të komuniteteve pakicë, organizatave të shoqërisë civile, si dhe përfaqësues të organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare.

Detyrat më të rëndësishme të këtij trupi punues do të ishin t'i propozojë qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës miratimin e rregulloreve të caktuara bazuar në ligjet ekzistuese dhe nëse është e nevojshme të propozojë miratimin e të reja. Një detyrë tjetër shumë e rëndësishme e këtij organi do të ishte vendosja e kuotave të sakta për punësimin e komuniteteve pakicë në sektorin publik për secilin komunitet veç e veç.

Gjithashtu, ky trup punues duhet të monitorojë në mënyrë të përhershme procesin e zbatimit të masave dhe aktiviteteve për arritjen e qëllimit 3 dhe në bazë të raporteve që merr, të propozojë dhe të marrë masat e nevojshme korigjuese për eliminimin e vështirësive të mundshme në arritjen e qëllimit.

Për të realizuar objektivin specifik 3.1, duhet të ndërmerren hapat si në vijim:

- Përcaktimi i numrit të saktë të anëtarëve në trupit punues dhe kriteret për përzgjedhjen e institucioneve që duhet të përfaqësohen në këtë trup (propozim)
 - o Ministrinë (anëtarësimi në postin e ministrit ose sekretarit)
 - o Vetëqeverisjet lokale (anëtarësimi sipas funksionit – kryetarët e komunave)
 - o Përfaqësuesit e komuniteteve pakicë (shoqata, OJQ)
 - o Drejtorët e Zyrave për Komunitete dhe përdorimin e gjuhëve, etj.
-
- Përcaktimi i detyrave të sakta, qëllimi trupit punues, mandatet e anëtarëve, zgjedhjen e kryesuesit të trupit punues (propozojmë që ai të jetë drejtor i zyrës për komunitete ose ministër i MKK-ës)
 - Bazuar në vlerësimin gjithëpërfshirës, të përcaktohen kuotat e sakta për përfaqësimin proporcional të komuniteteve pakicë në sektorin publik në Kosovë.
 - Institucionalizimi i metodologjisë së raportimit të të gjitha institucioneve publike për arritjen e kuotave të caktuara në të ardhmen.
 - Mbi bazën e raportit, i propozon organeve më të larta marrjen e masave për arritjen sa më të mirë të qëllimit të përgjithshëm.

Objektivi specifik 3.2 Ofrimi i mbështetjes ligjore dhe teknike për monitorimin e zbatimit të programit

Për të arritur qëllimin e përgjithshëm strategjik 3, është e nevojshme të monitorohet në mënyrë permanente realizimi i tij dhe të përmirësohen kushtet në mënyrë që niveli i arritjes të jetë sa më i lartë. Prandaj të gjitha institucionet që do të përfshihen në këtë proces duhet që rregullisht t'i raportojnë trupit punues të formuar në qëllimin specifik 3.2 për përfaqësimin e komuniteteve pakicë në radhët e tyre. Raportet duhet të flasin jo vetëm për paraqitjen numerike, por të shoqërohen edhe me komente për vështirësitë e mundshme në realizimin e këtij qëllimi, si dhe duhet të përmbajnë rekomandime specifike se si të arrihet qëllimi në nivelin më të lartë të mundshëm. Gjithashtu, duhet të përcaktohet perioda e vetë raportimit (mujore, tremujore, vjetore).

Për ta realizuar qëllimin specifik 3.2, duhet të ndërmerren hapat si në vijim :

- Institucionalizimi i metodologjisë së raportimit të të gjitha institucioneve publike për arritjen e kuotave të caktuara në të ardhmen.
- Përcaktimi se kujt dhe kur i dorëzohen raportet
- Përcaktimi i formës së formularit për raportim

- Përgatitni raporte përfundimtare që duhet t'u dorëzohen instancave më të larta institucionale që mund të marrin vendime që do të kishin ndikim në arritjen e qëllimit strategjik 3.
- Prezantimi publik i raporteve për arritjen e qëllimit strategjik 3.

VI.4. OBJEKTIVI STRATEGJIK 4

Objektivi strategjik 4: Zhvillimi i mekanizmave dhe shërbimeve për përdorimin e gjuhëve

MKK-ja sipas mandatit të saj vepron në komunat me shumicë serbë lidhur me përkrahjen në ofrimin e shërbimeve për përdorimin e gjuhëve.

Siç vërehet edhe në analizën më lart, mundësia e përdorimit të barabartë të gjuhëve zyrtare përbën të drejtë themelore, të garantuar edhe me Kushtetutën e Kosovës. Ngecjet kryesore në fushën e përdorimit të gjuhëve konsistojnë në gabimet e dukshme në përkthimet e legjislacionit të Kosovës në gjuhët zyrtare, respektivisht, në gjuhën serbe, pastaj edhe sfidat me infrastrukturën për përkthim në sistemin e drejtësisë së Kosovës, si dhe qasjen në korrikulat në gjuhët e komuniteteve në arsimin parauniversitar dhe arsimin e lartë të Kosovës.

Andaj, zhvillimi i mekanizmave dhe shërbimeve për përdorimin e gjuhëve mbetet prioritet për MKK dhe Qeverinë në përgjithësi. Kjo objektivë synohet që të arrihet përmes aktiviteteve të ndryshme dhe bashkëpunimin me partnerët zbatues dhe ndërkombëtar.

Gjuha e komuniteteve jo shumicë duhet të ofrohet në mënyrë vullnetare për t'u mësuar si gjuhë ambiente për komunitetet e tjera si lëndë shtesë ose zgjedhore, në mënyrë që të përmirësohet dialog për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë.

Ngritja e kapaciteteve për përkthimin në gjuhën turke nëpër institucionet e nivelit qeveritar përfshirë sigurimin e hapësirave dhe përkthyesve.

Kjo do të realizohet përmes ndjekjes së masave strategjike të mëposhtme:

- Përmirësimi i koordinimit institucional në hartimin e legjislacionit dygjuhësor;
- Fuqizimi i mekanizmave për përcjelljen e zbatimit të legjislacionit për përdorimin e gjuhëve.

Për arritjen/përmbushjen e objektivës strategjike janë paraparë këto objektiva specifike:

Objektivi specifik 4.1. Përmirësimi i harmonizimit dygjuhësor gjatë hartimit të legjislacionit në Kosovë;

VI. ANALIZA SWOT

Objektivi strategjik	Përparësitë	Dobësitë	Mundësitë	Rreziqet
<i>Objektivi strategjik 1</i>	<i>Interesimi i lartë i Qeverisë dhe BE-së për integrimin e komuniteteve dhe përmirësimin të mirëqenies së tyre;</i>	<p><i>1. Mungesa e të dhënave për personat e zhvendosur;</i></p> <p><i>2. Mungesa e kornizës adekuate ligjore;</i></p> <p><i>3. Mungesa e koordinimit ndër-institucional;</i></p>	<i>1. Bashkëpunimi dhe përkrahja nga donatorët;</i>	<p><i>1. Perceptimi i situatës së sigurisë nga PZHBV-të ndikon negativisht në vendosjen për kthim;</i></p> <p><i>2. Lokacione komplekse ku kthimi nuk është i mirëpritur nga komuniteti pritës/shumicë;</i></p> <p><i>3. Mungesa e zgjidhjeve banesore për PZHBV-të pa pronë apo ofrimi i mundësive për banim social;</i></p> <p><i>4. Mos lirimi i pronave të uzurpuara dhe tej zgjatja e kontesteve gjyqësore pronësore</i></p> <p><i>5. Hezitimi nga ana e autoriteteve i pranimit të kthimit në vendin tjetër përveç në vendin e origjinës, etj.</i></p>

<p><i>Objektivi strategjik 2</i></p>	<p><i>Interesimi i lartë i Qeveris, BE-së dhe donatorëve të tjerë për integrimin e komuniteteve dhe përmirësimin të mirëqenies së tyre duke ofruar mundësi të punësimit</i></p>	<p><i>Mungesa e të dhënave për popullsinë e katër komunave veriore;</i></p>	<p><i>1. Bashkëpunimi dhe përkrahja nga donatorët;</i></p>	<p><i>1. Informimi jo i mirë 2. Niveli i ulët i edukimit 3. Mos zbatimi i ligjit për kuoten e punësimit për komunitetet.</i></p>
<p><i>Objektivi strategjik 3</i></p>	<p><i>Kushtetuta e Republikës së Kosovës, përcaktonë organizimin shtetëror duke garantuar komunitetet joshumicë që e definojnë Kosovën si "shoqëri multietnike, e cila qeveriset në mënyrë demokratike me respekt të plotë të sundimit të ligjit përmes institucioneve legislative, ekzekutive dhe gjyqësore".</i></p>	<p><i>Mos zbatimi i dispozitave Kushtetuese – ligjore dhe instrumenteve juridike të garantuara me kushtetutë</i></p>	<p><i>Mundësitë zbatimi i plotë i të drejtave të garantuara</i></p>	<p><i>Mos respektimin i instrumenteve kushtetuese juridike</i></p>
<p><i>Objektivi strategjik 4</i></p>	<p><i>Miratimi i Koncept Dokumentit që parasheh</i></p>	<p><i>1. Mungesa e Njesisë për përkthim, kontroll</i></p>	<p><i>1. Numri i mjaftueshëm i zyrtarëve të</i></p>	<p><i>1. Mungesa e buxhetit për rekrutimin e</i></p>

	<i>themelimin e njësisë së re për përkthim, kontroll gjuhësor dhe harmonizim</i>	<i>gjuhësor dhe harmonizim;</i> <i>2. Mungesa e kapaciteteve njerëzore për përkthim të projekt-legjislacionit në administratën shtetërore</i>	<i>punësuar për përkthim</i>	<i>përkthyesve gjyqësor.</i>
--	--	--	------------------------------	------------------------------

VII. RREGULLIMI I ZBATIMIT, MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT

Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK) është themeluar në vitin 2005, dhe është ministria kyçe e ngarkuar me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, është e mandaturuar që të realizojë monitorimin e zbatimit të Strategjisë për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre 2023-2027 dhe si rrjedhojë edhe e Planit të saj të Veprimit.

Synimi kryesor i institucioneve të Kosovës, është pa dyshim zbatimi në tërësi i dokumentit strategjik, proces ky që do të paraprihet nga realizimi i aktiviteteve dhe objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit nëpër vite. Procesi i zbatimit të strategjisë, do të jetë një proces i realizimit të synimeve strategjike dhe objektivave të saj.

Për zbatimin e objektivave strategjike, është hartuar Plani i Veprimit tre vjeçar dhe është bërë kostimi i plotë për tri vitet e para. Në këtë plan veprimi përcaktohen objektivat specifike, aktivitetet konkrete karshi institucioneve përgjegjëse dhe mbështetëse për zbatimin e tyre, gjendja ekzistuese, synimi/targeti, burimet financiare, të cilat janë përlllogaritur dhe do të përfshihen në kornizën afatmesme të shpenzimeve (KASH) si dhe afatet kohore për përmbushjen e tyre. Gjithashtu, në përlllogaritjen e nevojave financiare janë marrë në konsideratë edhe projektet me financim nga donatorët, në vijim ose të planifikuara, sipas fushave specifike.

Të gjitha institucionet qendrore dhe lokale, obligohen të ndërmarrin masat e nevojshme për zbatimin të detyrimeve të përcaktuara në Strategjisë për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave

të Komuniteteve dhe Pjesëtareve të tyre 2022-2026 dhe si rrjedhojë edhe të Planit të Veprimit për zbatimin e strategjisë nëpër vite, në përputhje me përgjegjësitë dhe mandatin ligjor të tyre.

Monitorimi dhe vlerësimi i realizimit të objektivave dhe efektshmërisë së aktiviteteve përkatëse, janë pjesë integrale e strategjisë dhe komponentë kryesorë të procesit të zbatimit të saj. Monitorimi dhe vlerësimi do të shërbejnë për të ndjekur ecurinë e zbatimit të strategjisë, për të matur në proces shkallën e realizimit të objektivave të saj, për të vlerësuar nevojën dhe përcaktuar drejtimit e rregullimeve, veçanërisht lidhur me aktivitetet. Procesi i monitorimit do të realizohet nga institucionet përgjegjëse me pjesëmarrjen e gjerë të grupeve të interesuara. Organizatat e shoqërisë civile gjithashtu do të angazhohen dhe luajnë rol të rëndësishëm në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të aktiviteteve dhe masave të parashikuara në planin e veprimit të Strategjisë për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtareve të tyre 2022-2026.

Monitorimi do të jetë proces kyç për ofrimin e informatave të nevojshme për qëllime llogaridhënieje, ai nuk do të jetë efektiv nëse nuk ndërmerren veprime ndaj asaj që është vlerësuar dhe raportuar. Andaj, çdo 6 muaj dhe fund vit mekanizmat përgjegjës duhet të hartojnë raportin 6 muajor dhe vjetor i cili duhet të përmbajë vlerësimin e aktiviteteve më të suksesshme dhe në përgjithësi përmbushjen e qëllimeve të strategjisë, identifikimin e sfidave dhe vështirësive të hasura gjatë procesit të zbatimit si dhe ofrimin e rekomandimeve konkrete për mënjanimin e pengesave të paraqitura përgjatë procesit të përmbushjes së objektivave specifike dhe atyre strategjike. Përgjegjësia primare për hartimin e këtij raporti është përcaktuar të jetë e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim. Kjo Ministri, përmes një formulari që do të përpilohet në muajt e parë të zbatimit të strategjisë, do të kërkojë dhe mbledhë rregullisht të dhëna nga të gjitha institucionet bartëse në realizimin e masave dhe aktiviteteve të parashikuara në planin e veprimit të kësaj Strategjie. Më pas do të bëhet përpunimi i informacionit të mbledhur, si dhe përgatitja e raportit të monitorimit, bazuar në treguesit e përcaktuar si në aktivitete, ashtu edhe në nivel objektivash specifike e strategjike. Të dhëna do të kërkojen dhe do të mblidhen edhe nga organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë të cilat veprojnë në fushën e komuniteteve jo-shumicë dhe kthimit të tyre si dhe nga organizatat ndërkombëtare e donatorët që kanë në fokus të punës së tyre këtë çështje.

Monitorimi i zbatimit të dokumentit strategjik dhe efektivitetit të tij janë esenciale:

- (i) për të siguruar që po arrihen qëllimet,
- (ii) për të monitoruar kontributet e investuara dhe aktivitetet,
- (iii) për të siguruar nëse zbatimi po shkon sipas rrjedhës së përcaktuar,
- (iv) për të paralajmëruar institucionet përgjegjëse për problemet/ngecjet ose problemet potenciale para se situata të bëhet kritike,
- (v) për të sugjeruar veprime korigjuese ose për të rishikuar strategjinë në bazë të përvojës së fituar.

Duke monitoruar strategjinë dhe treguesit e performancës, institucionet do të jenë në gjendje të krijojnë një pasqyrë mbi gjendjen, d.m.th. në ç'pikë ndodhet strategjia drejt arritjes së qëllimeve të përcaktuara, nxjerrjes së mësimëve, marrjes së masave korigjuese, dhe nëse është e mundur, proceseve rishqyrtuese të saj. Është parë që monitorimi është më i dobishëm kur nxirren mësimë nga procesi i zhvilluar, të cilat pastaj shfrytëzohen për procese në të ardhmen. Prandaj, gjatë

monitorimit të efektivitetit të zbatimit të strategjisë një gjë e tillë duhet pasur parasysh. Në këtë kuptim, strategjia do të jetë një dokument dinamik, që do t'i përshtatet ndryshimit të objektivave, rrethanave dhe përvojës së fituar.

Ndërsa raportet e monitorimit janë parashikuar të jenë gjashtë mujore dhe vjetore, është e rëndësishme që të kryhet edhe një proces i vlerësimit afatmesëm të zbatimit të strategjisë, përpara vlerësimit përfundimtar të saj. Ky vlerësim që mund të parashikohet të kryhet p.sh. në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2024, mund të shërbejë për të bërë një riorganizim të parashikimeve në planin e veprimit të Strategjisë varësisht ecurisë afatmesme në zbatim. Kjo do të ndihmonte që të arriheshin edhe qëllimet afatmesme dhe afatgjata të parashikuara në këtë strategji. Përveç vlerësimit afatmesëm, është menduar që të realizohet edhe një proces i vlerësimit në tërësi të përbushjes së qëllimeve të kësaj strategjie, në vitin e fundit të zbatimit të saj, si parapërgatitje për veprime të mëtejshme përtej vitit 2026.

VIII. NDIKIMI BUXHETOR I ZBATIMIT TË STRATEGJISË

Plani i Veprimit për zbatimin Strategjisë për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtareve të tyre 2022-2026, ka një kosto totale të zbatimit prej **xxxxxx euro** për tri vite të zbatimit (2022-2024).

Pjesa më e madhe e kostos (rreth 00% e buxhetit) do të përdoret për shpenzimet rrjedhëse që lidhen me ngritjen e kapaciteteve, mbështetjen dhe fuqizimin e shërbimeve të specializuara, rregullimin e sistemit të monitorimit dhe raportimit që ka të bëjë me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, si dhe aktivitetet për kthimin e personave të zhvendosur etj.

Tabela 1. Paraqet një përmbledhje të buxhetit për zbatimin e Planit sipas llojeve dhe viteve, ndërsa kjo bazohet në kalkulime të detajuara të shpenzimeve për secilin objektiv të planifikuar.

Zbatimi i planit të veprimit për 3 vite e para do të kërkojë mjete financiare siç tregohet në tabelën më poshtë në milionë euro (KT- Buxheti i përgjithshëm për Planin e Veprimit, KR- kostot rrjedhëse, K – kapital kapitale, SG – subvencionet dhe garantët).

Tabela 2. Paraqet një përmbledhje të buxhetit për zbatimin e Planit sipas burimeve të financimit.

Tabela 3. Paraqet një shpërndarje të shpenzimeve në kategori të sektorëve dhe sipas viteve për zbatimin e Planit.

Tabela 1. Përmbledhja e buxhetit sipas objektivave dhe viteve

Objektivat Strategjike	2023				2024				2025			
	KT	KR	K	SG	KT	KR	K	SG	KT	KR	K	SG
Kthimi, ri integrimi, integrimi dhe ofrimi i mundësive të	1,2 58, 000	258 ,00 0	1,0 00.		5,65 0,91 6	227 ,00 0	5,4 23,		5,6 99, 166	224 ,50 0	5,4 74,	

zgjdhjes së qëndrueshme për personat e zhvendosur dhe të kthyerit vullnetarë jo-shumicë, me objektivat specifike si në vijim:			00 0				91 6			16 6	
Stabilizimi i komuniteteve dhe përmirësimi i mirëqenies së tyre duke ofruar mundësi të barabarta të punësimit, shërbimeve sociale dhe të mbrojtjes, si dhe arsimit, me objektivat specifike si në vijim:	5,1 34, 600	134 ,60 0	5,0 00, 00 0		5,12 5,34 9	125 ,34 9	5,0 00, 00 0		5,1 66, 600	116 ,60 0	5,0 00, 00 0
Përfaqësimi proporcional i komuniteteve pakicë në administratën publike, me objektivat specifike si në vijim	8,0 00. 00	8,0 00. 00	-		-	-	-		-	-	-
Zhvillimi i mekanizmave dhe shërbimeve për përdorimin e gjuhëve	2,5 00. 00	2,5 00. 00	-		-	-	-		-	-	-
	6,405,600.00				10,776,265.00				10,699,166.00		
	27,881,031.00										

Tabela 2. Struktura e shpenzimeve sipas viteve të planifikuara në plan të veprimit dhe burimit të financimit

Vitet	Shpenzime totale		
	BRK	Donatorët	Total:
2023	7,672,606.00	1,644,575.85	9,317,181.85
2024	12,255,518.80	1,932,382.90	14,187,901.70
2025	12,365,222.24	1,901,178.40	14,266,400.64
Total:	32,293,347.04	5,478,137.15	37,771,484.20

Tabela 3. Shpërndarja e shpenzimeve në kategori sipas sektorëve dhe sipas viteve është si vijon:

Vitet	2023	2024	2025
Paga dhe mëditje	941,691.30	571,011.80	779,126.40
Mallra dhe Shërbime	710,398.70	670,318.20	719,193.60
Shpenzime Kapitale	9,317,181.85	14,187,901.70	14,266,400.64
Gjithsej	10,969,271.80	15,429,231.70	15,764,720.60

IX. PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË PËR MBROJTJEN DHE PROMOVIMIN E TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE DHE PJESËTARËVE TË TYRE 2023-2027

Nr.	Objektivat strategjike dhe specifike, treguesit dhe veprimet	Vlera bazë	Objektivi i përkohshëm [2025]	Synimi i vitit të fundit [2027]	Rezultati
I.	Objektivi strategjik: Kthimi, ri integrimi, integrimi dhe ofrimi i mundësive për zgjidhjen e qëndrueshme për personat e zhvendosur dhe të kthyerit vullnetarë te komuniteteve jo-shumicë.				
1	Treguesi: Numri i masave të marra nga nivelet përkatëse qeveritare për avancimin e zgjidhjeve të qëndrueshme për personat e zhvendosur në kuadër të bashkëpunimit rajonal (Procesi i Shkupit).	Të dhënat nga 2016 deri 2021	Tri veprime të zbatuara në kuadër të pikave të veprimit (në kuadër të Procesit të Shkupit).	Të gjitha veprimet e zbatuara sipas pikave të veprimit (në kuadër të Procesit të Shkupit).	Procesi i Shkupit ka qenë i rëndësishëm në fillimin dhe sigurimin e dialogut dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm në rajon për të gjetur zgjidhje për njerëzit që mbeten në zhvendosje. Nisma rajonale synon gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme për personat e zhvendosur nga Kosova, duke përfshirë edhe kthimin dhe integrimin e të zhvendosurve në vendet e zhvendosjes.
2.	Treguesi: Zhvillimi i planeve komunale të veprimit për të kthyerit dhe personave të zhvendosur.	10	20	28	Të gjitha komunat zhvillojnë planet e veprimit sipas Rregullores Nr.02/2010 për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim.
I.1	Objektivi specifik: Angazhimi i intensifikuar i institucioneve relevante në lidhje me ofrimin e shërbimeve për kthimin dhe ri integrimin e personave të zhvendosur				
I.1.1.	Treguesi: Institucionet e përfshira në bashkëpunimin rajonal (Procesi i Shkupit) marrin pjesë në takimet rajonale.	1.1.1. Njëmbë dhjetë takime të	1.1.1. Janë mbajtur të paktën dy takime rajonale	1.1.1. Janë mbajtur të paktën katër	1.1.1. Të diskutohet progresi i arritur në nivel rajonal në gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme për personat e zhvendosur nga Kosova, duke përfshirë edhe kthimin

		forumit të nivelit të lartë dhe grupit teknik të punës, duke përfshirë gjashtë takime dypalëshe që nga viti 2015.		takime rajonale.	dhe integrimin e të zhvendosurve në vendet e zhvendosjes.
I.1.2	Treguesi: numri i personave të trajnuar (të raportohet në bazë të llojeve të trajnimeve dhe personave të trajnuar).	91 persona (për Bazë të të dhënave).	120	150	Personat e trajnuar
I.1.3	Treguesi: funksionalizimi i bazës së të dhënave	Në proces	Baza e të dhënave funksionale	N/A	Është bërë funksionalizimi i bazës së të dhënave, ku të gjitha PZH-të mund të aplikojnë për Kthim dhe regjistrimin e tyre.

